

UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN
FAKULTETI I EDUKIMIT
NIVELI MASTER
PROGRAMI: MËSIMDHËNIE DHE KURRIKULA NË ARSIMIN FILLOR



TEZA MASTER

Mentorja:

Prof. Asoc. Dr. Nerxhivane Krasniqi

Kandidatja:

Flakrona Gashi

Gjilan, 2025

UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN

FAKULTETI I EDUKIMIT

NIVELI MASTER

PROGRAMI: MËSIMDHËNIE DHE KURRIKULA NË ARSIMIN FILLOR



TEZA MASTER

**NDIKIMI I EDUKIMIT PARASHKOLLOR TË INSTITUCIONALIZUAR NË
ZHVILLIMIN E AFTËSIVE SOCIALE TË FËMIJËVE**

Mentorja:

Prof. Asoc. Dr. Nerxhivane Krasniqi

Kandidatja:

Flakrona Gashi

Gjiilan, 2025

© [2025]- [Flakrona Gashi] Të gjitha të drejtat e rezervuara.

DEKLARATË

Unë deklaroj me përgjegjësi të plotë se ky punim është produkt i punës sime të palodhur dhe të pavarur. Çdo përmbajtje e huazuar është e cituar dhe referuar në mënyrë të saktë sipas udhëzimeve akademike. Sipas të dhënave dhe njohurive që kam, konfirmoj se ky punim nuk është paraqitur dhe nuk është publikuar më parë, as nga unë dhe as nga ndonjë individ tjetër.

Gjithashtu, deklaroj se gjatë shkrimit të këtij punimi kam respektuar plotësisht rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të UKZ-së.

DEDIKIM

Këtë punim të tezës së masterit ia dedikoj me gjithë zemër familjes sime të shtrenjtë për mbështetjen e pakushtëzuar dhe dashurinë e pafundme që më kanë dhënë gjatë gjithë jetës, e veqanërisht gjatë formimit dhe rrugëtimit tim profesional dhe akademik.

FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE

Ky punim i temës së masterit nuk do të mund të realizohej pa përkrahjen e njerëzve më të dashur që kanë kontribuar në realizimin e këtij punimi. Për këtë arsye, jam mirënjohëse dhe i falënderoj pafund të gjithë ata që më kanë mbështetur, jo vetëm tani, por gjatë gjithë rrugëtimit tim akademik. Falënderoj mentoren time të nderuar, Prof. Asoc. Dr. Nerxhivane Krasniqi për motivimin, përkrahjen dhe ofrimin e këshillave në finalizimin e këtij punimi. Shpreh një mirënjohje të thellë edhe ndaj profesorëve të tjerë të stafit akademik në Fakultetin e Edukimit të cilët kanë kontribuar në njohuritë dhe shkathtësitë e mija profesionale, pa të cilët nuk do të ishte i mundur ky sukses.

Po ashtu, dua të shpreh mirënjohjen dhe falenderimin më të thellë ndaj familjes sime, e cila ka qenë një shtyllë e fortë për mua në çdo hap të jetës dhe shkollimit tim. Familja më ka dhënë forcën dhe motivin për të përfunduar me sukses këtë rrugëtim dhe i detyrohem shumë për falenderime dhe dashuri të pafundme ndaj tyre.

Falënderoj edukatoren dhe prindërit e shkollave pjesëmarrëse në hulumtim, pa përgjigjet e të cilëve nuk do të kisha mundur ta realizoj hulumtimin.

ABSTRAKT

Edukimi parashkollor është një periudhë e rëndësishme në jetën e fëmijëve, ku ata zhvillojnë bazat e aftësive sociale, si komunikimi, bashkëpunimi dhe empatia. Kjo periudhë i ndihmon fëmijëve në formimin e personalitetit dhe të aftësive sociale që do të ndikojnë në jetën e tyre të mëvonshme. Përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor me qëllim të zhvillimit të aftësive sociale paraqet vlerën e edukimit parashkollor. Vlera e edukimit parashkollor vihet në pah nga përfshirja e fëmijëve për tre vite në kopsht nga mosha 3-6 vjeç që ndikon më shumë në rritjen e zhvillimit të aftësive sociale krahasuar me përfshirjen e fëmijëve vetëm në klasën përgatitore në moshën 5-6 vjeçare.

Ky hulumtim ka për qëllim të analizojë ndikimin e edukimit parashkollor të institucionalizuar në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijët, konkretisht ndërveprimin me edukatoren dhe bashkëmoshatarët. Pikë tjetër kyçe e punimit është edhe të analizojmë ndikimin e mjedisit fizik dhe lojës si faktorë në zhvillimin social të fëmijëve. Do të bëhet edhe krahasimi mes fëmijëve që kanë vijuar kopshtin për tri vite krahas fëmijëve që kanë ndjekur vetëm klasën përgatitore. Hulumtimi është realizuar në 5 shkolla publike dhe në 2 institucione parashkollore në komunën e Gjilanit. Shkollat e përfshira në hulumtim janë: SHFMU “Selami Hallaçi”, SHFMU “Musa Zajmi”, SHFMU “Abaz Ajeti”, SHFMU “Thimi Mitko” dhe SHFMU “Rexhep Elmazi”, si dhe IP “Dardania” dhe IP “Integji”. Pjesëmarrës në hulumtim kanë qenë edukatorët dhe prindërit e fëmijëve që ndjekin edukimin parashkollor.

Metodologjia e këtij hulumtimi është metodologji sasiore (anketimi i edukatorëve dhe prindërve). Janë anketuar 50 prindër dhe 30 edukatore, gjithsej 80 pjesëmarrës në hulumtim. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur një pyetësor i strukturuar me pyetje të mbyllura, i ndarë për dy palët—një për edukatorët dhe një për prindërit. Me anë të analizës statistikore kemi bërë krahasimin e qëndrimeve dhe vlerësimeve të dy grupeve pjesëmarrëse.

Gjetjet e këtij hulumtimi ofrojnë një bazë krahasuese për hulumtimet e ardhshme mbi këtë temë, duke ndihmuar në zhvillimin e politikave arsimore më të përshtatshme për edukimin në fëmijërinë e hershme, me theks në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.

Fjalët kyçe: *Edukim parashkollor, Aftësi sociale, Institucione parashkollore, Kopsht/Çerdhe, Klasë përgatitore, Mjedis fizik, Loja, Empatia.*

ABSTRACT

Preschool education is an important period in children's lives during which they develop the foundations of social skills, such as communication, cooperation, and empathy. This period helps children in shaping their personality and social abilities, which will influence their future lives. The inclusion of children in preschool education with the aim of developing social skills highlights the value of early childhood education. The value of preschool education is particularly evident when children attend kindergarten for three years, from ages 3 to 6, which has a greater impact on the development of social skills compared to attending only the preparatory class at ages 5–6.

This research aims to analyze the impact of institutionalized preschool education on the development of children's social skills, specifically their interaction with educators and peers. Another key point of the study is to analyze the influence of the physical environment and play as factors in children's social development. A comparison is also made between children who have attended kindergarten for three years and those who have only attended the preparatory class. The research was conducted in five public schools and two preschool institutions in the municipality of Gjilan. The schools included in the study are: SHFMU "Selami Hallaçi," SHFMU "Musa Zajmi," SHFMU "Abaz Ajeti," SHFMU "Thimi Mitko," and SHFMU "Rexhep Elmazi," as well as the preschool institutions IP "Dardania" and IP "Integj." Participants in the study were both educators and parents of children attending preschool education.

The methodology of this research is quantitative, involving surveys of educators and parents. A total of 80 participants were surveyed — 50 parents and 30 educators. A structured questionnaire with closed-ended questions was used to collect data, designed separately for the two groups — one for educators and one for parents. Through statistical analysis, we compared the attitudes and assessments of the two participant groups.

The findings of this study offer a comparative basis for future research on this topic, contributing to the development of more suitable educational policies for early childhood education, with an emphasis on the development of children's social skills.

Keywords: *Preschool education, Social skills, Preschool institutions, Kindergarten/Nursery, Preparatory class, Physical environment, Play, Empathy.*

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	7
ABSTRACT	8
LISTA E FIGURAVE.....	11
LISTA E TABELAVE	12
KAPITULLI 1.....	13
HYRJE	13
1.1 Prezantimi i problemit.....	15
1.2 Qëllimi i hulumtimit.....	15
1.3 Objektivat e hulumtimit	16
1.4 Pyetjet e hulumtimit	16
KAPITULLI 2.....	17
SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	17
2.1 EDUKIMI PARASHKOLLOR.....	17
2.2 FËMIJËRIA E HERSHME	19
2.3 TEORITË E ZHVILLIMIT DHE TË NXËNIT TË FËMIJËVE	20
2.3.1 Teoria kognitive e Jean Piaget	21
2.3.2 Erik Erikson dhe teoria e tij mbi zhvillimi social, emocional dhe mendor të fëmijëve	22
2.3.3 Teoria bihevioriste	24
2.3.4 Teoria socio-kognitive e të mësuarit.....	24
2.3.5 Teoria socio-kulturore e Lev Vigotskit	25
2.3.6 Teoria e inteligjencave të shumfishta e Gardnerit	26
2.3.7 Teoria bioekologjike e Bronfenbrenrit.....	26
2.4 ZHVILLIMI SOCIAL.....	28
2.4.1 INTEGRIMI NË MJEDISIN SOCIAL	30
2.5 KOMPETENCA SOCIALE.....	32
2.6 RËNDËSIA E LOJËS NË ZHVILLIMIN E AFTËSIVE SOCIALE	34
2.7 RËNDËSIA E MJEDISIT FIZIK NË ZHVILLIMIN E AFTËSIVE SOCIALE	35
2.7.1 Hapësira.....	37
KAPITULLI 3.....	39
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	39

3.1 Lloji dhe qasja e hulumtimit.....	39
3.2 Pyetjet e hulumtimit	39
3.3 Hipotezat e hulumtimit.....	39
3.4 Popullata dhe mostra e hulumtimit.....	40
3.5 Instrumenti i mbledhjes së të dhënave	40
3.6 Procedura e analizës së të dhënave	41
3.7 Etika e hulumtimit.....	41
3.8 INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË HULUMTIMIT	42
3.9 Rezultatet e të dhënave në formën tabelare dhe të figurave nga pyetësi i realizuar me Edukatorët.	42
3.10 Rezultatet e të dhënave në formën tabelare dhe të figurave nga pyetësi i realizuar me prindërit	60
3.11 PËRFUNDIMET	75
3.12 REKOMANDIMET	76
3.13 Referencat bibliografike.....	77
3.14 SHTOJCAT	80
3.15 Shtojca B: PYETËSOR PËR PRINDËR	86

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 . Analizimi i të dhënave të mbledhura për përvojën e edukatorëve.	43
Figura 2. Analizimi i të dhënave të mbledhura mbi zhvillimin e profesionit të edukatorëve.	45
Figura 3. Analizimi i të dhënave të mbledhura për identifikimin e grupmoshës së fëmijëve që punojnë edukatorët.	46
Figura 4. Analizimi i të dhënave të mbledhura për ndihmën e edukimit parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.....	48
Figura 5. Analizimi i të dhënave të mbledhura për nivelin e zhvillimit të aftësive sociale para vijimit të edukimit parashkollor.....	49
Figura 6. Analizimi i të dhënave të mbledhura për përmirësimet e aftësive sociale të fëmijëve.....	50
Figura 7. Analizimi i të dhënave të mbledhura për aftësitë e fëmijëve për të bashkëpunuar me fëmijët e tjerë.....	51
Figura 8. Analizimi i të dhënave të mbledhura për ndikimin e aftësive sociale në zhvillimin gjuhësor dhe emocional të fëmijëve.	52
Figura 9. Analizimi i të dhënave të mbledhura për dizajnimin e mjedisit fizik në klasë. ...	55
Figura 10. Analizimi i të dhënave të mbledhura për sigurinë e hapsirave të jashtme për zhvillimin e lojërave sociale.....	56
Figura 11. Analizimi i të dhënave të mbledhura për materialet dhe paisjet që nxisin lojëra sociale.....	57
Figura 12. Analizimi i të dhënave të mbledhura për llojet e lojës më ndikim më të lartë në zhvillimin e aftësive sociale.....	59
Figura 13. Analizimi i të dhënave të mbledhura për gjininë e prindërve, pjesëmarrës në hulumtim	61
Figura 14. Analizimi i të dhënave të mbledhura për moshën e fëmijës.	62
Figura 15. Analizimi i të dhënave të mbledhura për llojin e vijimit të edukimit parashkollor të fëmijëve.	64
Figura 16. Analizimi i të dhënave të mbledhura për ndikimin e edukimit parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.....	66
Figura 17. Analizimi i të dhënave të mbledhura për nivelin e zhvillimit të aftësive sociale të fëmijëve.....	67
Figura 18. Analizimi i të dhënave të mbledhura për rëndësinë e sjelljes pozitive të fëmijëve.	68
Figura 19. Analizimi i të dhënave të mbledhura mbi kënaqsinë e prindërve për qasjen e edukimit parashkollor të insitucionalizuar.....	70
Figura 20. Analizimi i të dhënave të mbledhura për aktivitetet që kontribuojnë më shumë në zhvillimin e aftësive sociale.....	71
Figura 21. Analizimi i të dhënave të mbledhura për ndihmën e edukimit parashkollor për marrëdhëniet sociale në shkollë fillore dhe mjedise tjera?.....	73

Figura 22. Analizimi i të dhënave të mbledhura për vlerësimin e punës së edukatorëve në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.....	74
---	-----------

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Numri i edukatorëve pjesëmarrëse në shkolla në hulumtim.....	42
Tabela 2. Numri i edukatorëve pjesëmarrëse në institucione parashkollore në hulumtim.....	42
Tabela 3. Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për nivelin e arsimimit të edukatorëve.	44
Tabela 4. Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për numrin e fëmijëve në grup/klasë parashkollore.....	47
Tabela 5. Rezultatet e analizës së të dhënave për identifikimin e aftësive sociale që janë më të vështira për tu zhvilluar në moshën parashkollore.	53
Tabela 6. Rezultatet e analizës së të dhënave për aktivitetet në kopsht/ klasë që kontribuojnë më shumë në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.	54
Tabela 7. Rezultatet e analizës së të dhënave për rëndësinë e lojës në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.....	58
Tabela 8. Numri i prindërve pjesëmarrës në shkolla.....	60
Tabela 9. Numri i prindërve pjesëmarrës në institucione parashkollore.	60
Tabela 10. Rezultatet e analizës së të dhënave për punësimin e prindërve.	63
Tabela 11. Rezultatet e analizës së të dhënave për arsyen e dërgimit të fëmijëve në edukimin parashkollor të insitucionalizuar.	65
Tabela 12. Rezultatet e analizës së të dhënave për përmirësimin e zhvillimit të aftësive sociale të fëmijëve.....	69
Tabela 13. Rezultatet e analizës së të dhënave për përdorimin e pasijeve teknologjike të fëmijëve.....	72

KAPITULLI 1

HYRJE

Edukimi parashkollor është një proces i strukturuar dhe i organizuar që përfshinë periudhën nga mosha 0 deri në 6 vjeç, përpara se fëmijët të fillojnë shkollën fillore. Ky lloj edukimi mund të ofrohet në mjedise të ndryshme si çerdhe, kopshte, klasa parashkollore, apo edhe në kushte familjare me mbështetje nga institucionet e edukimit. Ai ka për qëllim të mbështesë zhvillimin e aftësive intelektuale, sociale, emocionale dhe fizike të fëmijëve, duke i përgatitur ata për suksesin në shkollë dhe në jetën shoqërore (Shonkoff & Phillips, 2000). Edukimi parashkollor luan një rol të rëndësishëm pasi siguron një mjedis të strukturuar dhe të sigurt, ku fëmijët mund të zhvillojnë aftësi të rëndësishme sociale. Aktivitetet parashkollore si komunikimi, bashkëpunimi dhe ndihma ndaj të tjerëve janë thelbësore për zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve (Denham, 2006). Fëmijët që ndjekin programe të edukimit parashkollor të institucionalizuar kanë mundësi më të mëdha për të ndërtuar marrëdhënie pozitive dhe për të zhvilluar aftësi të menaxhimit të emocioneve, si dhe të zgjidhjes së konflikteve në mënyrë të efektshme (Berk, 2009). Përmes aktiviteteve grupore dhe lojërave të strukturuar, ata mësojnë të komunikojnë, të ndajnë dhe të kuptojnë nevojat dhe ndjenjat e të tjerëve, duke ndihmuar kështu në zhvillimin e aftësive të bashkëpunimit dhe të ndërveprimit të shëndetshëm social. Këto aftësi janë të rëndësishme jo vetëm për suksesin në shkollë, por edhe për jetën e përditshme dhe për integrimin e tyre në shoqëri (T.Bowman & Donovan, 2001)

Edukimi parashkollor i institucionalizuar është një formë e strukturuar e edukimit që ofron mundësi për zhvillimin social dhe emocional, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe stimulues për fëmijët. Siç vërehet në shumë studime, pjesëmarrja në këto programe mund të ndikojë pozitivisht në aftësitë e fëmijëve për të ndihmuar ata të përmirësojnë ndërveprimet e tyre me bashkëmoshatarët dhe edukatorët. Edukimi parashkollor ka një ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimin e fëmijëve, veçanërisht në aspektin e aftësive sociale, të cilat janë thelbësore për ndërveprimet e suksesshme me të tjerët gjatë gjithë jetës. Shumë studime kanë treguar se fëmijët që marrin një edukim parashkollor të cilësisë së lartë janë më të aftë të krijojnë lidhje shoqërore, të komunikojnë efektivisht dhe të menaxhojnë emocionet e tyre. Kjo temë është e rëndësishme jo vetëm për edukimin parashkollor, por edhe për zhvillimin e një shoqërie të shëndetshme dhe

bashkëpunuese, ku aftësitë sociale luajnë një rol kyç. Zhvillimi social i fëmijëve është një proces kompleks dhe i shumëanshëm që përfshin aftësinë e fëmijëve për të ndërvepruar me të tjerët, për të zhvilluar dhe menaxhuar emocionet e tyre dhe për të ndërtuar marrëdhënie pozitive dhe të shëndetshme me individë të tjerë. Ky zhvillim ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mundësitë që fëmijët kanë për të përshtatur me normat dhe vlerat shoqërore dhe për të ndikuar në suksesin e tyre të ardhshëm në shkollë dhe në jetë (Berk, 2009). Zhvillimi i aftësive sociale është një komponent kyç që ndihmon fëmijët të krijojnë lidhje të shëndetshme dhe të arrijnë sukses në mjedise të ndryshme sociale dhe edukative.

Në këtë punim, do të shqyrtojmë ndikimin e edukimit parashkollor të institucionalizuar në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve. Përmes literaturës ekzistuese dhe studimeve të ndryshme, do të analizojmë se si programet edukative që ofrohen në këto institucione mund të ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë aftësitë e nevojshme sociale për të ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme dhe të efektshme me fëmijë të tjerë dhe me të rriturit. Ky punim mund të ndihmojë gjithashtu në përmirësimin e praktikave dhe politikave të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe moshën parashkollore, duke kontribuar në një zhvillim më të balancuar dhe të qëndrueshëm të shoqërisë. Punimi synon të shqyrtojë ndikimin e edukimit parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve, duke analizuar bashkëpunimin me moshatarët, ndërveprimin me edukatoren, rëndësinë e mjedisit fizik dhe të lojës si dhe dallimet në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijët që e kanë ndjekur vetëm klasën përgatitore në krahasim me ata fëmijë që e kanë ndjekur kopshtin/çerdhen nga mosha 3 vjeqare.

1.1 Prezantimi i problemit

Në kohët e sotme, edukimi parashkollor përbën një fazë themelore në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës, me një rëndësi të veçantë në zhvillimin e aftësive sociale që ndikojnë në zhvillimin e tyre në jetë dhe të arriturat e tyre në shoqëri, me ndërveprimin me të tjerët, përshtatjen në mjedise të reja dhe përgatitjen për jetën shkollore. Megjithatë, ekzistojnë ende dilema dhe mungesë të të dhënave të mjaftueshme në vendin tonë rreth ndikimit të vërtetë që ka edukimi parashkollor, në zhvillimin social të fëmijëve e në veçanti kur ai vijohet për një periudhë më të gjatë. Po ashtu, cilësia e mjedisit edukativ, loja, mënyra e ndërveprimit me edukatoren dhe bashkëmoshatarët, si dhe përmbajtja e aktiviteteve ditore luajnë rol kyç në këtë proces, por jo gjithmonë vlerësohen në mënyrë sistematike.

Një dimension tjetër i rëndësishëm që trajton ky hulumtim është qëndrimi i prindërve ndaj efektivitetit të edukimit parashkollor. Vlerësimi i këtyre qëndrimeve është thelbësor për të kuptuar pritshmëritë që kanë prindërit nga institucionet parashkollore, si dhe për të identifikuar boshllëqet mes praktikës arsimore dhe përceptimit të përfitimeve sociale të fëmijëve nga ky proces.

1.2 Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të analizojë efektet e edukimit parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve, duke u fokusuar në ndikimin e cilësisë së ndërveprimit me edukatoren dhe bashkëmoshatarët.

Përveç kësaj, hulumtimi synon të vlerësojë rolin e cilësisë së mjedisit fizik dhe lojës në zhvillimin social të fëmijëve në institucionet parashkollore. Kjo përfshin shqyrtimin e programeve të aktiviteteve dhe rolit të edukatorëve në krijimin e një ambienti pozitiv dhe gjithëpërfshirës që nxit zhvillimin social në harmoni me vlerat kulturore dhe nevojat socio-emocionale të fëmijëve.

Në veçanti, ky hulumtim do të kërkojë të përcaktojë nëse pjesëmarrja trevjeçare në edukimin parashkollor (nga mosha 3 deri në 6 vjeç) ka një ndikim më të madh në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve në krahasim me pjesëmarrjen e fëmijëve vetëm në klasën përgatitore, duke marrë parasysh edhe variacionet e mundshme në cilësinë e ofrimit të edukimit parashkollor. Gjithashtu

pikë tjetër e këtij hulumtimi është të shohim edhe qëndrimet e prindërve për efektet pozitive të edukimit parashkollor.

1.3 Objektivat e hulumtimit

1. Analizimi i efekteve të edukimit parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.
2. Vlerësimi i mjedisit fizik dhe i lojës në zhvillimin e marrëdhënieve ndërpersonale të fëmijëve.
3. Analizimi i dallimeve në zhvillimin e aftësive sociale të pjesëmarrjes trevjeçare në edukimin parashkollor me pjesëmarrjen vetëm në klasën përgatitore (mosha 5-6 vjeç).
4. Qëndrimet e prindërve për efektet pozitive të edukimit parashkollor në socializimin e fëmijëve të tyre.

1.4 Pyetjet e hulumtimit

1. Cilat janë efektet e edukimit parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve?
2. Cili është roli i ndërveprimit me edukatoren dhe bashkëmoshatarët në procesin e zhvillimit të aftësive sociale?
3. Si e përceptojnë prindërit ndikimin e edukimit parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve të tyre?
4. Çfarë ndikimi ka mjedisi fizik dhe loja në ndërveprimin social të fëmijëve?

KAPITULLI 2

SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 EDUKIMI PARASHKOLLOR

Edukimi parashkollor përbën një ndër fazat më të rëndësishme në jetën e një fëmije. Ai është baza mbi të cilën ndërtohet e gjithë struktura e mëvonshme e arsimit dhe zhvillimit personal. Në këtë periudhë, që përfshin fëmijët nga mosha 0 deri në 6 vjeç, ndodhin ndryshimet më të mëdha në zhvillimin kognitiv, emocional, gjuhësor dhe social. Në këtë kuptim, edukimi parashkollor nuk është thjesht përkujdesje për fëmijët, por një formë e strukturuar dhe thelbësore e mësimdhënies e bazuar në nevojat dhe potencialin e secilit fëmijë. “Edukimi apo arsimi parashkollor paraqet nivelin e parë të edukimit, gjatë të cilit fëmijët edukohen në familjet e tyre ose në institucione parashkollore që nga mosha (0-3 dhe mosha 3-5 vjec). Pjesë e këtij niveli është edhe klasa përgatitore (mosha 5-6 vjec) që mund të organizohet në institucione parashkollore ose edhe në klasa përgatitore” (MASHT, Korniza kurrikulare e Kosoves, 2016).

Edukimi parashkollor është një periudhë kyçe e zhvillimit të fëmijëve që përfshin mësimin dhe përgatitjen për shkollën në një mjedis të strukturuar dhe të sigurt, ku fëmijët zhvillojnë aftësi të rëndësishme intelektuale, sociale dhe emocionale. Ky proces mund të përfshijë aktivitete të ndryshme që nxisin krijimin e aftësive për komunikim, bashkëpunim dhe zgjidhjen e problemeve, të cilat janë të nevojshme për suksesin në shkollë dhe në jetën e përditshme (T.Bowman & Donovan, 2001). Hulumtimet e mëparshme kanë treguar se fëmijët që ndjekin programe të edukimit parashkollor janë më të aftë në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale, që janë thelbësore për formimin e marrëdhënieve të shëndetshme dhe për adaptimin në situata të reja.

Edukimi parashkollor mbështetet në standardet e zhvillimit dhe të nxënies në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç, standarde të cilat mbështesin dhe nxisin zhvillimin optimal të fëmijëve. Mosha parashkollore paraqet një periudhë të zhvillimit të shpejtë fizik, njohës, emocional dhe social të fëmijëve. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj periudhe të zhvillimit në vendosjen e një baze të mirë për të nxënë gjatë gjithë jetës, ekspozimi i fëmijëve ndaj proceseve elementare të të nxënies do të fokusohet në nxitjen e kërshërisë së tyre për veten, për shoqërinë, për natyrën, dijen, kulturën dhe për teknologjitë e reja. Synim i punës edukative në këtë periudhë është edhe stimulimi/nxitja

i kreativitetit dhe entuziazmit për qasje ndaj përvojave të reja dhe përballjes me situata reale jetësore. Gjatë këtij niveli të edukimit, fëmijët përkrahen në zhvillimin e shkathtësisë komunikuese në gjuhën shqipe në situata të thjeshta të përditshmërisë, në zhvillimin e vëmendjes së tyre dhe aftësive të përqendrimit si dhe në zhvillimin e shkathtësive themelore sociale, njohëse, kreativitetit si dhe në zhvillimin e koncepteve themelore matematikore (MASHT, Korniza kurrikulare e Kosoves, 2016).

Në dekadat e fundit, hulumtimet e ndryshme kanë theksuar vazhdimisht rëndësinë e investimeve në edukimin e hershëm, duke e cilësuar atë si çelës për zhvillimin e qëndrueshëm dhe uljen e pabarazive shoqërore. Po ashtu, shumë studime kanë treguar se fëmijët që ndjekin programe cilësore parashkollore, kanë më shumë gjasa të arrijnë rezultate më të mira akademike dhe të jenë të suksesshëm në jetën e tyre të mëvonshme (Schweinhart, Barnes, & Weikart, 1993).

Qëllimi kryesor i edukimit parashkollor është të sigurojë zhvillim të gjithanshëm për fëmijët, duke respektuar ritmet individuale dhe duke nxitur aftësitë e tyre natyrore. Në këtë fazë, truri i fëmijës është në një gjendje të jashtëzakonshme përthithjeje dhe përmes ndërveprimit me të rriturit dhe bashkëmoshatarët, fëmija mëson të shprehë veten, të bashkëpunojë, të mendojë në mënyrë kritike dhe të ndërtojë vetëbesimin. Përveç zhvillimit personal, edukimi parashkollor ka ndikim të drejtpërdrejtë në përgatitjen e fëmijëve për arsimin fillor. Fëmijët që ndjekin kopshte cilësore kanë më pak vështirësi në përshtatje, tregojnë rezultate më të mira në të lexuar, matematikë dhe shkenca, si dhe janë më të aftë për të ndërtuar marrëdhënie pozitive me të tjerët. Qëllim tjetër i edukimit parashkollor është të nxitet zhvillimi fizik, emocional, social, kognitiv dhe gjuhësor i fëmijëve në një mjedis të sigurt dhe stimulues. Në këtë periudhë, fëmijët mësojnë përmes lojës, ndërveprimit dhe eksperiencave praktike. Sipas (UNESCO, 2021) edukimi i hershëm ndihmon fëmijët të ndërtojnë themelet për të mësuar gjatë gjithë jetës dhe për zhvillimin personal e shoqëror.

Edukimit në fëmijërinë e hershme i është dhënë rëndësi edhe nga institucionet shtetërore, kjo dëshmohet me hartimin e ligjit për edukimin në fëmijërinë e hershme ku sipas tij: **(Ligji Nr.08/L-153 Për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, 2023)** "Edukimi në fëmijërinë e hershme i referohet edukimit të fëmijëve për t'i stimuluar në arritjen e potencialit të tyre të plotë nga lindja deri në momentin që hyjnë në klasën e parë në shkollën fillore, edukimi në fëmijërinë e hershme në familje nënkupton edukimin, kujdesin dhe zhvillimin e fëmijëve në ambientin familjar që realizohet nga prindërit/kujdestarët ligjor, me ose pa mbështetje të ofruar nga institucionet

përgjegjëse për zhvillimin e fëmijëve në moshën e hershme”. Qëllimet e edukimit në fëmijërinë e hershme janë të: promovojë zhvillimin tërësor, duke përfshirë edukimin, shëndetin dhe mirëqenien e çdo fëmije, të stimulojë zhvillimin fizik, kognitiv, gjuhësor, social, emocional dhe të personalitetit.

Edukimi i hershëm është pjesa më kryesore e edukimit të fëmijëve, duke qenë vendimtare për mënyrën se si një fëmijë zhvillohet. Nëse në vitet e para fëmija ka një zhvillim të shëndetshëm, atij i'u mundësohet që të bëjë ndërtimin e blloqeve të trurit për arritje akademike, produktivitet ekonomik, qytetari përgjegjëse, jetë të shëndetshme dhe prindërim të suksesshëm për gjeneratën tjetër (Pacolli, Ramqaj, & Behrami, 2020).

Programet parashkollore i'u mësojnë fëmijëve shkathtësi të vlefshme për t'i ndihmuar ata të gjejnë gjuhën e përbashkët me bashkëmoshatarët. Mund t'i mësojnë si të luajnë dhe të komunikojnë me njëri-tjetrin, si t'i kontrollojnë emocionet e tyre dhe të zgjidhin problemet që shfaqen në situatat sociale. Programet parashkollore ju mësojnë fëmijëve shkathtësitë sociale përmes tregimeve modeluese, fotografive, dramatizimeve dhe t'i praktikojnë ato përmes lojërave me role dhe lojërave tjera. Ato mund t'i aftësojnë fëmijët për lojë bashkëpunuese, të folur dhe të shprehur, rregullim emocional, kontrollë të agresivitetit dhe zgjidhje të problemeve. Ato individualisht mund të udhëzojnë fëmijët si të ftojnë tjetrin në lojë apo si të ndihmojnë shokun/shoqen e tyre (Shehu, 2021)

2.2 FËMIJËRIA E HERSHME

Përgjatë historisë, roli i edukimit të hershëm dhe rëndësia e tij në zhvillimin e fëmijëve është promovuar me ide të ndryshme nga një sërë mendimtarësh, përfshirë teologë, filozofë, psikologë dhe pedagogë. Në njohuritë dhe filozofitë e këtyre mendimtarëve, përmes së cilave shpjegohen modele të zhvillimit dhe të të mësuarit të fëmijëve, bazohen programet e kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme në vende të ndryshme të botës (Duraku, 2021).

Fëmijëria e hershme paraqet një mundësi unike për të vendosur bazat për një zhvillim të shëndoshë të fëmijëve. Gjatë viteteve të para të jetës së fëmijës përcaktohet edhe zhvillimi socio-emocional i tyre në të ardhmen. Përvojat paraprake pozitive, në aspektin social stimulojnë shëndetin mendor të fëmijëve dhe ndikojnë në zhvillimin e tyre njohës, social dhe emocional (Shehu, 2021).

Zhvillimi në fëmijërinë e hershme është një proces i gjerë, që përfshinë periudhën e hershme të fëmijërisë që nga periudha e para lindjes deri kur fëmijët mbushin moshën 6 vjeçare. Fushat e zhvillimit të fëmijëve janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe nuk janë të ndara por janë pjesëza të një tërësie. Pra, kur një fëmijë zhvillohet në një fushë të caktuar, ai zhvillim ndikon edhe në fushat e tjera (MASHT, Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, 2011).

Zhvillimi i hershëm i fëmiut përfshin zhvillimin fizik, socio-emocional, kognitiv dhe motorik nga mosha 0-6 vjeç. Vitet e para të jetës janë kritike sepse kjo është koha gjatë të cilës truri zhvillohet me një shpejtësi shumë të madhe duke pasur një kapacitet të lartë për ndryshim. Në këtë moshë vendosen themelet e krijimit të personalitetit, të personit/individit, pastaj krijimin e identitetit të vet personal, ngritjen e vetëbesimit fillimin e zhvillimit të njohurive dhe shkathtësive. Sa më shumë që punojmë me fëmijët e moshës së hershme, aq më shumë kemi benefite kur ata fillojnë shkollën apo kur vazhdojnë shkollimin e mesëm të ulët apo të lartë (Pacolli, Ramqaj, & Behrami, 2020).

2.3 TEORITË E ZHVILLIMIT DHE TË NXËNIT TË FËMIJËVE

Studimet që janë përqendruar në përshtatjen sociale tek mosha e rritur kanë nxjerrë në pah rëndësinë e vendosjes së themeleve të zhvillimit social në fëmijëri. Përgjatë zhvillimeve në fushën e arsimit, bazë për hartimin e programeve të edukimit të hershëm, vlerësohet të jenë pikëpamjet e psikologëve të zhvillimit dhe kontribuuesve të tjerë gjithashtu, përmes pikëpamjeve të të cilëve shpjegohet se si fëmijët mësojnë dhe se si duhet krijuar dhe përshtatur ambienti, në mënyrë që të mbështetet më së miri të nxënit e fëmijëve, në kontekste të ndryshme kulturore dhe sociale. (Duraku, 2021)

2.3.1 Teoria kognitive e Jean Piaget

Kjo teori ka qenë teori e parë që tregoi se prindi, por edhe vet fëmija ka rol aktiv në ndërveprimet me prindërit e vet, duke vënë kështu bazat e pikëpamjeve dy drejtimëshe në zhvillimin e fëmijës ku prindi dhe fëmija shihen si qenie që kanë ndikim aktiv mbi njëri-tjetrin (Shehu, 2021).

Sipas teorisë kognitiviste, proceset e të menduarit ndryshojnë vazhdimisht dhe në mënyrë rrënjësore, ato ndryshojnë nga lindja deri në moshën e pjekurisë që përfshijnë katër faza të zhvillimit kognitiv: Senzomotorike (0-2 vjec), Paraoperacionale (2-7 vjec), Faza operacionale konkrete (7-11 vjec) dhe Faza operacionale formale (11-15 vjec). Sipas Piazhësë të gjithë njerëzit trashëgojnë dy prirje bazë: organizimin dhe përshtatjen (Zabeli, 2023).

Organizimi nënkupton procesin e vazhdueshëm të sistemit të informacionit dhe përvojës në kategori, ndërsa përshtatja ka të bëjë me prirjen për t'iu përshtatur mjedisit përmes asimilimit, akomodimit dhe ekuilibrit. Asimilimi ndodh kur njerëzit përdorin skemat e tyre ekzistuese për të kuptuar dukuritë në botën që i rrethon. Asimilimi lidhet me përpjekjet për të kuptuar diqka të re, duke futur atë në skemat për ato që dimë. Akomodimi ndodh kur individit duhet të ndryshojë skemat ekzistuese për t'iu përgjigjur një situatë të re, nëse të dhënat nuk mund të futen në skemat ekzistuese, atëherë duhet ndërtuar strukturat e duhura. Në këtë rast përshtasim mendimin tonë me informacionin e ri (Woolfolk, 2011).

Njerëzit arrijnë të përshtaten në mjedise që bëhen gjithnjë e më komplekse, duke përdorur skemat ekzistuese sa herë që këto skema funksionojnë (asimilimi) dhe duke e modifikuar e shtuar skema të reja saherë del nevoja për diqka të re (akomodimi). Ekuilibrimi, sipas Piazhësë, organizmi, asimilimi dhe akomodimi mund të shihen ai akt i një drejtëpeshimi kompleks dhe ndryshimet konkrete në mendim kalojnë përmes procesit të ekuilibrit që është akt i kërkimit të një drejtëpeshimi të ri (Woolfolk, 2011). Zhvillimi kognitiv sipas Piazhësë, bazohet në konceptin e veprimit të njerzëve për të kuptuar botën përreth duke krijuar dije në mënyrë aktive nëpërmjet përvojave të drejtëpërdrejta me njerëz, ide dhe objekte dhe përshtatja ndodh duke formuar të menduarit përmes skemave. (Zabeli, 2023)

2.3.2 Erik Erikson dhe teoria e tij mbi zhvillimi social, emocional dhe mendor të fëmijëve

Eriksoni ishte veçanërisht i interesuar në lidhjen midis kulturës së mjedisit në të cilin rritet një fëmijë dhe çfarë lloj tiparesh ka ai pas disa vitesh. Ai shtroi hipotezën se të gjitha qeniet njerëzore kanë të njëjtat nevoja bazë dhe se çdo shoqëri duhet t'i sigurojë ato në një farë mënyre. Ky theksim mbi lidhjen e kulturës dhe të individit e çoi Eriksonin të propozojë një teori psikosociale të zhvillimit. Teoria e tij në pjesën më të madhe, u bazua në veprën e Frojdit, por Eriksoni shkoi përtej asaj që zhvilloi Frojdi mbi fëmijërinë e hershme dhe zhvillimin psikoseksual. Sikurse Piazhe dhe Frojdi, edhe Eriksoni e sheh zhvillimin si një kalim në seri fazash, secila me qëllime, interesa, realizime dhe rreziqe të veçanta. Ai parasheh tetë faza të zhvillimit të cilat ai i quan “tetë moshat e njeriut” (Musai, 1999). Në çdo fazë Erikson sugjeron se individët përjetojnë një krizë të zhvillimit, ne do të ndalemi tek tri fazat e para që kanë të bëjnë me fëmijën prej lindjes e deri në moshë 6 vjeçare.

Në fazën e parë apo foshnjërinë, fazë të cilën e përshkon besimi dhe mosbesimi konflikti bazë i kësaj faze prindërit dhe kujdesi i tyre luajnë rol të rëndësishëm. Faza tjetër e fëmijës që çapitet, që ka të bëjë me autonominë dhe ndjenjën e turpit e dyshimit, shënon fillimin e vetëkontrollit dhe të vetëbesimit. Fëmijët janë të aftë të veprojnë gjithnjë e më shumë vetë. Ata zhvillojnë aftësi fizike dhe mendore që i lejojnë njëfarë kontrolli mbi vetë jetën e tyre. Ata përpiqen të shkojnë drejtë autonomisë. Gjatë kësaj periudhe, prindërit duhet të ndjekin një linjë të drejtë duhet të jenë mbrojtës, por jo ta teprojnë. Në qoftë se prindërit nuk mbajnë qëndrim sigures e të besueshëm dhe nuk përforcojnë përpjekjet e fëmijës për të zotëruar aftësitë bazë motore dhe kognitive, fëmijët mund të fillojnë të ndjejnë turp, mësojnë të dyshojnë në aftësitë e tyre për të drejtuar botën sipas kuptimeve të tyre. Eriksoni beson se nëse fëmijët ndjejnë shumë dyshim në këtë fazë do të kenë mungesë besimi në aftësitë e tyre gjatë gjithë jetës (Gjelaj, 2014).

Sipas Eriksonit, fëmija tani duhet të përballojë konfliktin e iniciativës ndaj fajit. Për Eriksonin, “iniciativa i shton autonomisë cilësinë e ndërmarrjes, të planifikimit dhe të synuarit të një detyre për hir të të nxënies aktiv dhe në lëvizje”. Por, me iniciativë realizimi i disa veprimtarive është i ndaluar. Ndonjëherë, fëmijët mund të ndjejnë veten të ndarë midis asaj që ata duan të bëjnë dhe asaj që duhet bërë. Sfidat e kësaj periudhe është të ruhet interesi për veprimtari dhe në të njëjtën kohë të kuptohet se nuk mund të veprohet mbi çdo nxitje. Fëmijët në fazën e hershme të fëmijërisë mund ta mendojnë veten duke luajtur role të ndryshme të të rriturve dhe fillojnë të provojnë aftësitë

e tyre në detyrat e “të rriturit”. Një katërvjeçar ndihmon nënën e tij për të përzier brumin e biskotave apo i kalon veglat babait që po riparon një biçikletë të prishur, është i angazhuar në punë të rëndësishme. Fëmijët në këtë fazë janë shpesh adhures heronjsh, adhurojnë gjithashtu njerëz të rritur të idealizuar si doktorë, zjarrëfikës apo mësues. Loja është një formë e rëndësishme e iniciativës, lojërat pretenduese janë të zakonshme. (Musai, 1999)

Fëmijët në këtë fazë kërkojnë konfirmim nga të rriturit që iniciativa e tyre të pranohet dhe se ndihmësit e tyre, s’ka rëndësi sa të paktë të jenë, të vlerësohen realisht. Këta fëmijë janë të etur për përgjegjësi. Rritja e sukseshme gjatë kësaj periudhe qëndron mbi ndjenjën se ata janë pranuar për veten e tyre. Përsëri të rriturit duhet të ecin mbi një rrugë të menduar mirë, kësaj here në sigurimin e një mbikqyrjeje, por pa ndërhyrje. Në qoftë se fëmijët nuk lejohen të bëjnë gjëra vetë, mund të zhvillohet një ndjenjë faji ata mund të arrijnë të besojnë se çfardo që duan të bëjnë është gjithmonë e “gabuar” (Karaj, 2005).

Puna e Eriksonit ka rëndësi të madhe për fëmijërinë e hershme, sepse tregon se si fëmijët zhvillojnë bazat për zhvillimin emocional, social dhe mendor (Mooney, 2000). Teoria e tij psikosociale na bën të mendojmë se duke filluar nga rrethi familjar e deri në shkollë dhe komunitet, fëmijët do të jenë të ndikuar nga ta dhe do të varen nga po ky ndikim. Edukimi i fëmijëve gjatë moshës parashkollore dhe faktorët social kanë një peshë shumë të madhe në përgatitjen e tyre për klasë të parë. Siç edhe vërehet nga Teoria e Eriksonit, prindërit, mësuesit dhe fëmijët e tjerë përreth do të mundësojnë një zhvillim të pasur mendor, social e emocional nëse vërtetë veprojnë sipas kërkesave të Eriksonit. Ata do të përgatisin fëmijën që shkollën fillore ta fillojnë pa ndjenjën e frikës, fajit e inferioritetit nëse përkrahin fëmijët që të jenë të pavarur në vendimet dhe veprimet e tyre, të nxisin iniciativën dhe të forcojnë vetëbesimin. Vetëm kështu fëmija do të shkojë në klasën e parë pa e vërejtur shkëputjen zingjimore të edukimit të mëtutjeshëm dhe do të jetë në gjendje të ndjejë kënaqësitë nga puna, suksesi dhe bashkëveprimi me të tjerët (Gjelaj, 2014).

2.3.3 Teoria biheavioriste

Bazohet në të mësuarit me anë të sjelljeve e që i jep rëndësi socializimit duke u përqendruar në sjelljet që mund të vëzhgohen në mënyrë objektive. Sjellja mund dhe duhet të studiohet objektivisht, pra ato sjellje dhe reagime që mund të vëzhgohen nga ana e jashtme, që mund të maten dhe të analizohen. Reagimet apo sjelljet janë një funksion, janë pasojë e gjërave të tilla si p.sh përforcimi dhe ndëshkimi. Një nga synimet kryesore të bihejvorizmit janë që të zbulojë ligjet që drejtojnë marrëdhënien mes stimuljeve, (kushteve të mjedisit që shkaktojnë reagimet) dhe reagimeve (sjelljeve). Po ashtu një synim kryesor i bihejvorizmit është që të zbulojë se si mund të kontrollohen reagimet (sjelljet) përmes përdorimit të përforcimeve dhe ndëshkimeve. Bihejvoristët të mësuarit e shohin si përvetësim i sjelljeve të reja (Karaj, 2005). Ithtarët e bihejvorizmit shprehin se përvetësimi i sjelljeve të reja zhvillohet nga kushtëzimi klasik i cili shpie në reagimet e pavullnetshme emocionale nga veprimet automatike që ndryshe quhen reflekse. Në anën tjetër njerëzit nuk mësojnë vetëm në këtë mënyrë të paqëllimshme, ata mësojnë në mënyrë të qëllimshme duke ndërvepruar me mjedisin, pra duke operuar dhe procesi i të mësuarit që shpie në sjelljet operante quhet kushtëzim operant, i zhvilluar nga B.Skinner. Sipas pikëpamjeve bihejvoriste, përforcimi dhe ndëshkimi ndikojnë drejtpërdrejtë mbi sjelljen (Zabeli, 2023).

2.3.4 Teoria socio-kognitive e të mësuarit

Kjo teori e zhvilluar nga Bandura, pranon dallimet midis të nxëniet dhe performancës dhe thekson mësimin përmes vëzhgimit të të tjerëve (Woolfolk, 2011). Të mësuarit sipas Bandurës realizohet nëpërmejt vëzhgimit dhe gjithashtu konkludohet se në procesin e të mësuarit përveq modeleve sociale (sjelljes), përfshihen edhe faktorët kognitiv (Zabeli, 2023).

Teoria socio-kognitive bazohet në idenë që ne mësojmë nga ndërveprimet tona me të tjerët në një kontekst social. Veçmas, duke vëzhguar sjelljet e të tjerëve, njerëzit zhvillojnë sjellje të ngjashme. Pasi vëzhgojnë sjelljen e të tjerëve, njerëzit e asimilojnë dhe imitojnë sjelljen, veçanërisht nëse përvojat e tyre vëzhguese janë pozitive ose përfshijnë shpërblime lidhur me sjelljen e vëzhguar. Sipas Bandurës, imitimi përfshin aktualitetin riprodhimi i aktiviteteve motorike të vëzhguara, ai beson se përforcimi i drejtpërdrejtë nuk mund të llogaritet në të gjitha llojet e mësimin. Për këtë arsye, në teorinë e tij ai shtoi një element social, duke argumentuar se njerëzit mund të mësojnë informacione dhe sjellje të reja duke parë njerëzit e tjerë. Sipas elementeve të kësaj teorie

ekzistojnë tre parime të përgjithshme për të mësuar nga njëri-tjetri. Parimet e të mësuarit social supozohet se funksionojnë në të njëjtën mënyrë gjatë gjithë jetës. Mësimi vëzhgues mund të bëhet në çdo moshë. Për sa i përket ekspozimit ndaj ndikimeve të reja, ka modele të fuqishme që kontrollojnë burimet që mund të ndodhin në fazat e jetës, të mësuarit e ri përmes modelimit është gjithmonë i mundur. Teoria socio-kognitive na tregon se njerëzit mësojnë nga njëri-tjetri, nëpërmjet: • Vëzhgimit • Imitimit dhe • Modelimit (Woolfolk, 2011).

Bazuar në këto parime të përgjithshme, të mësuarit mund të ndodhë pa një ndryshim në sjellje. Në teoritë e tjera si p.sh bihevizistët thonë se të mësuarit duhet të përfaqësohet nga një ndryshim i përhershëm në sjellje, Bandura thotë se të mësuarit mund ose nuk mund të rezultojë në një ndryshim të sjelljes. Teoria socio-kognitive është një teori e të mësuarit e cila ka dalë mbi idetë që njerëzit mësojnë duke parë se çfarë bëjnë të tjerët dhe se proceset e mendimit njerëzor janë pikë kyqe për të kuptuar personalitetin. Për më tepër, teoria e Banduras vendos një fokus të madh në konceptet njohëse. Përqendrohet gjithashtu në mënyrën se si fëmijët dhe të rriturit veprojnë në mënyrë kognitive mbi përvojat e tyre sociale dhe si këto njohje pastaj ndikojnë në sjelljen dhe zhvillimin (Bijandi & Nabavi, 2011). Teoria socio-kognitive vë theksin te roli i njerëzve të tjerë që shërbejnë si modele dhe si mësues (pjesa sociale e teorisë), por përfshinë edhe të menduarit, të besuarit, të parashikuarit dhe të bërit e krahasimeve dhe të vlerësimeve (pjesa kognitive e teorisë). Kjo teori është sistem dinamik që shpjegon përshtatjen njerëzore, të nxënës dhe motivimin, ka në qendër mënyrën se si njerëzit përfitojnë aftësi shoqërore, emocionale, kognitive dhe të sjelljes, gjithashtu atë se si njerëzit e rregullojnë jetën e tyre dhe çfarë i motivon ata. Të nxënësit duke vëzhguar të tjerët është element kyq në teorinë socio-kognitive. Bandura gjithashtu thekson rëndësinë e vetëefikasitetit si proces i njohjes së aftësive që ka një njeri për ti kryer me sukses detyrat e tij, gjë që ndikon në zhvillimin e përgjithshëm të individit (Woolfolk, 2011).

2.3.5 Teoria socio-kulturore e Lev Vigotskit

Vigotski na tregon që zona e zhvillimit proksimal (të përafërt) është distanca në mes të asaj që fëmijët mund të bëjnë vetëm dhe asaj që mund të bëjnë me ndihmën e të tjerëve, kjo nënkupton atë që fëmija mëson në bashkëveprim, sipas tij fëmija ka nevojë për ndihmë, mbështetje dhe udhëzime (Karaj, 2005). Sipas kësaj teorie fëmija ka nevojë për ndërveprim me të tjerët për të zhvilluar veprimtaritë e tij jetësore. Teoria e zhvillimit social e Vygotsky-t bazohet në atë se lojërat dhe

ndërveprimet sociale luajnë një rol themelor në zhvillimin kognitiv të fëmijës. Sipas kësaj teorie, ndërveprimi social i paraprindë zhvillimit, ndërsa vetëdija dhe kognicioni janë produkti i fundit i socializimit dhe sjelljes sociale. Vygotsky në teorinë e tij përqendrohet në lidhjet mes njerëzve dhe kontekstit sociokulturor në të cilin ata veprojnë dhe ndërveprojnë përmes shkëmbimit të përvojave të tyre. Vygotsky theksonte se secili funksion në zhvillimin e fëmijës ndodh njëherë në nivelin social e më tutje në nivelin individual, që do të thotë se njëherë ndodh mes njerëzve (ndërpersonal) e pastaj me veten (intrapersonal). Sipas Vygotskyt, potenciali i zhvillimit kognitiv varet nga ‘zona e zhvillimit proksimal’, që nënkupton nivelin e zhvillimit të arritur përmes ndërveprimeve sociale. Zhvillimi i plotë i kësaj zone arrihet kur kemi zhvillim të plotë në fushën e ndërveprimeve sociale. Sipas Vygotsky-t, sa më shumë që ka fëmija bashkëpunim të shëndoshë me moshatarët, aq më shumë plotësohet zona e zhvillimit proksimal, dhe rrjedhimisht aq më shumë rritet potenciali për zhvillim të mirëfilltë kognitiv (Shehu, 2021).

2.3.6 Teoria e inteligjencave të shumfishta e Gardnerit

Rëndësi në zhvillimin e kompetencës sociale i është dhënë edhe në Teorinë e inteligjencave të shumfishta të Gardnerit, ku sipas tij njeriu posedon tetë, përkatësisht nëntë inteligjenca, në këto inteligjenca përfshihet edhe inteligjenca ndërpersonale, që është një aftësi për lidhje dhe ndërveprim me të tjerët, për të kuptuar gjendjen e të tjerëve, reagimin pozitiv, aftësitë për të parë perspektivat e të tjerëve, empatinë dhe bashkëpunimin. Gjithashtu edhe inteligjenca intrapersonale ka rëndësi në rregullimin e sjelljes personale, aftësitë për të njohur vetvetën dhe vetëreflektim (Zabeli, 2023).

2.3.7 Teoria bioekologjike e Bronfenbrenrit

Teori që na tregon se në zhvillimin e fëmijës kanë ndikim shumë kontekste shoqërore dhe ndërveprimet midis tyre. Kjo teori ngërthen faktorin bio dhe faktorin ekologjik, faktori bio paraqet faktin se njeriu gjatë procesit të zhvillimit posedon vlerat e tij biologjike, kurse faktori ekologjik, nënkupton faktin që sistemet shoqërore janë aktivisht të ndërvepruara dhe ndikojnë në njëri tjetrin (Zabeli, 2023).

Bronfenbrenner vuri në dukje se kushtet ekonomike, natyra e lagjes, familja dhe marrëdhëniet familjare të zgjeruara dhe mjedisi edukativ, të gjitha ndikojnë në zhvillimin e një fëmije (Slaughter, 2007). Gjatë dekadave të kaluara, studiuesit janë përpjekur të përcaktojnë faktorët që kontribuojnë në dështimin e fëmijëve për të krijuar marrëdhënie sociale dhe për të arritur sukses akademik. Midis këtyre faktorëve, janë studiuar edhe variablat socio-demografikë. (DiPerna, 2006) supozoi se duke hulumtuar të dhënat socio-demografike, profesionistët mund të kuptonin më mirë ndikimin që demografia ka në zhvillimin e fëmijëve.

Duke parë faktorët socio-demografikë nga këndvështrimi i teorisë së sistemit të kornizës ekologjike, ne bëhemi të vetëdijshëm për rrjetin kompleks të faktorëve që formësojnë zhvillimin e fëmijëve. Duke filluar nga mikrosistemi, i cili përfaqëson rrethin e menjëhershëm të fëmijës, ndaj edhe më së shumti ndërlidhet me kushtet e jetesës së fëmijës dhe modelet e ndërveprimit midis anëtarëve të familjes.

Programet e edukimit të hershëm bazohen gjithashtu në teorinë e vetëaktualizimit të Abraham Maslow (1908-1970), sipas së cilës nevojat bazike të fëmijëve duhet të jenë të përmbushura në mënyrë që të ndodhë të mësuarit. Për më shumë, sipas kësaj pikëpamjeje, mjediset arsimore luajnë një rol aktiv në përmbushjen e nevojave themelore të fëmijëve, meqë fëmijët kanë nevojë për mjedise të cilat mbështesin nevojat themelore të tyre. Maslow promovoi idenë se në kuadër të zhvillimit të kurrikulës për fëmijët nga programet arsimore, si dhe përgjatë punës me fëmijë, zhvillimi social dhe emocional duhet të jetë pjesë thelbësore dhe se institucioni duhet të sigurojë mundësi që fëmijët të krijojnë ndjenjën e arritjes, duke ofruar një ambient tërheqës dhe të këndshëm për edukim (Duraku, 2021).

2.4 ZHVILLIMI SOCIAL

Zhvillimi social nënkupton aspektin se si fëmija ndërvepron me mjedisin që e rrethon dhe mënyrën se si këto ndërveprime ndikojnë në zhvillimin e tij. Në këtë mjedis bëjnë pjesë (prindërit, kujdestarët, edukatorët, familjarët, moshatarët dhe të rriturit e tjerë).

Zhvillimi social i mundëson fëmijës të njohë mjedisin social që e rrethon, mjedisin kulturor dhe traditën, si dhe të zhvillojë kuptimin për mjedisin. Sjellja e hershme sociale ndikohet në masë të madhe nga praktikat e prindërve për rritjen e fëmijëve, duke përfshirë mënyrën se si prindërit realizojnë zbatimin e rregullave, si i japin ndihmën dhe nxitjen fëmijës së tyre (MASHT, Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, 2011). Zhvillimi social i referohet procesit përmes të cilit fëmija mëson të ndërveprojë me të tjerët në rrethin e tij/saj, dhe si i tillë, nënkupton fitimin e përvojës në marrëdhëniet shoqërore dhe të mësuarit për t'u përshtatur me mjedisin përreth, krijimin e lidhjeve dhe miqësive me të rriturit dhe bashkëmoshatarët (Zigler, Gilliam, & Jones, 2006).

Zhvillimi social nënkupton të fituarit e pjekurisë në marrëdhëniet sociale dhe të zotëruarit e aftësive për t'u përshtatur të tjerëve. Qysh në mosha më të hershme, fëmija ndjen nevojë për t'u shoqëruar me dikë, nevojë kjo që zhvillohet më vonë në tendencë të përhershme të njeriut për shoqëri. Marrëdhëniet dhe ndërveprimet sociale, posaçërisht me bashkëmoshatarët luajnë një rol qenësor në zhvillimin e shëndoshë të fëmijës dhe mundësitë për socializim në periudhat më të hershme të jetës mund të jenë rast i veçantë për të fituar pjekuri në krijimin e marrëdhënieve të suksesshme dhe për tranzicion më të lehtë në sistemet formale (si shkolla) të ndërveprimeve të mëtutjeshme. Shkathtësitë sociale dhe emocionale janë çelësi për zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës (Shehu, 2021).

Zhvillimi social i fëmijëve i referohet mënyrës se si ata mësojnë të ndërveprojnë me të tjerët, të ndërtojnë marrëdhënie pozitive dhe të kuptojnë normat dhe pritshmëritë sociale të mjedisit ku rriten. Kjo përfshin zhvillimin e aftësive për bashkëpunim, ndarje, komunikim efektiv dhe zgjidhje të konflikteve në mënyrë paqësore. Sipas (Berk, 2009) zhvillimi social ndikohet nga përvojat ndërpersonale që fëmijët kanë me bashkëmoshatarët, të rriturit dhe figurat e kujdesit dhe luan një rol kyç në formimin e identitetit dhe përshtatjen e fëmijëve në jetën shoqërore dhe institucionale. Marrëdhëniet e hershme dhe cilësore krijojnë themelet për një zhvillim social të shëndetshëm,

duke ndihmuar fëmijët të mësojnë të jenë pjesë e një grupi dhe të ndërtojnë ndjeshmëri ndaj të tjerëve.

Sipas (Musai, 1999) zhvillimi social përfshinë ndryshimet sipas mënyrës së marrëdhënieve me të tjerët, me kalimin e kohës. Ndryshimet që ndodhin në fëmijërinë e hershme, pranojnë në përgjithësi pozitivisht dhe rezultojnë në ndryshime të sjelljes, që është më e përshtatshme, më e organizuar, më efektive dhe e një niveli më të lartë. Zhvillimi social nënkupton të fituarit e pjekurisë në marrëdhëniet sociale dhe të zotëruarit e aftësive për t'iu përshtatur të tjerëve. Gjatë viteve parashkollore, fëmijët zhvillojnë aftësi për t'u përfshirë në ndërveprime sociale. Zhvillimi social i ndihmon fëmijës të njohë mjedisin social që e rrethon, mjedisin kulturor dhe traditën, si dhe të zhvillojë kuptimin për komunitetin. Sjellja e hershme sociale ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga praktikatat e prindërve për rritjen e fëmijëve, duke përfshirë mënyrën se si prindërit realizojnë zbatimin e rregullave, si japin ndihmën dhe nxitjen fëmijës së tyre (MASHT, Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, 2011). Zhvillimi emocional ka të bëjë me aspektin si ndjehet fëmija për vetveten dhe për botën që e rrethon, si i shpreh ndjenjat, emocionet ndaj vetes dhe të tjerëve. Po ashtu përmes zhvillimit emocional të fëmijës bëhet rritja dhe edukimi i ndjenjës së besimit, miqësisë dhe bashkëpunimit. Zhvillimi i emocioneve ndikohet nga mjedisi shoqëror dhe mënyra se si njerëzit i përgjigjen atyre (MASHT, Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, 2011).

Zhvillimi social dhe emocional konsiderohet si një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës, veçanërisht duke pasur parasysh rëndësinë e tij në gatishmërinë e fëmijëve për shkollë. Zhvillimi social dhe emocional përbëhet nga marrëdhëniet që ka një individ me të tjerët, niveli i vetëkontrollit dhe motivimi dhe këmbëngulja që një person ka gjatë një aktiviteti (Shala, 2013).

Ndërveprimi i mirëfilltë i këtyre dy aspekteve të zhvillimit rezulton me kompetencën sociale dhe emocionale të fëmijës që manifestohet përmes aftësisë për të krijuar relacione të afërta dhe të sigurta me moshatarët e të rriturit duke i përjetuar, njohur, kuptuar, shprehur dhe kontrolluar emocionet e veta dhe të të tjerëve përreth tyre. Meqë këto dy aspekte apo nënfusha - zhvillimi social dhe zhvillimi emocional janë shumë ngushtë të lidhura dhe të ndërvarura nga njëra-tjetra, ato paraqiten si një fushë e integruar, e ndarë në dy nënfusha: nënfusha sociale dhe nënfusha emocionale. Integrimi përmbajtësor dhe praktik i kësaj fushe bëhet edhe përmes standardeve më të përgjithësuara, përmes indikatorëve dhe aktiviteteve që e konkretizojnë këtë ndërvarësi

(MASHT, Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, 2011). Stereotipet gjinore ndikojnë në masë të madhe në zhvillim emocional e social të fëmijës (djalë dhe vajzë) prandaj për një realizim të plotë e përmbajtësor të përmbajtjes së kësaj fushe duhet kushtuar vëmendje të veçantë gjithëpërfshirëse të fëmijëve. Aktivitetet në vijim do të duhej të realizohen me një ndjeshmëri të madhe ndaj dallimeve gjinore në harmoni me moshën e fëmijës. Duhet pasur parasysh se kompetenca sociale e fëmijës ndikohet në radhë të parë nga temperamenti individual i fëmijës, por edhe nga përjetimet jetësore të tij/saj dhe nga interaksioni i fëmijës me moshatarët, prindërit dhe të afërmit e tjerë (MASHT, Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, 2011).

Zhvillimi emocional- ka të bëjë me ndjenjat dhe reagimet afektive të individit, p.sh procesi i atashimit të foshnjat etj (Karaj, 2005). Zhvillimi emocional i fëmijëve përfshin aftësinë e tyre për të identifikuar, kuptuar, shprehur dhe menaxhuar emocionet në mënyrë të përshtatshme. Ky proces është i lidhur ngushtë me përvojat sociale që fëmijët kanë në mjedise të ndryshme, sidomos në familje dhe në institucione edukative. Sipas (Denham, 2006) zhvillimi emocional është thelbësor për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme, për suksesin akademik dhe për mirëqenien psikologjike të fëmijës. Ai përfshin elementë si vetëdija emocionale, rregullimi emocional, ndjeshmëria ndaj emocioneve të të tjerëve dhe shprehja e emocioneve në mënyra sociale të pranueshme. Përmes ndërveprimeve të përditshme dhe mbështetjes nga të rriturit, fëmijët mësojnë të përballen me sfidat emocionale, duke ndërtuar kështu bazat për një zhvillim të qëndrueshëm personal dhe social.

2.4.1 INTEGRIMI NË MJEDISIN SOCIAL

Procesi i integritimit në mjedisin social, duke i përvetësuar vlerat morale të sjelljes, njihet si proces i socializimit. Socializimi që fillon në familje, vazhdon edhe në institucionet parashkollore, nëse ky proces është i zhvilluar në formë të duhur, fëmija përshtatet shpejt në mjedisin parashkollor, në mënyrë të natyrshme përvetëson rregullat e sjelljes, bashkëpunon me edukatoren dhe me moshatarët e tij. Zhvillimi social zhvillohet edhe më mirë në lojrat me grupe, në aktivitetet e përbashkëta të lira, sidomos në mjedisin e lirë edukativ (Brada, 2013).

Bandura tregon se fëmijet mësojnë duke vëzhguar njerzit e tjerë duke marrë ide se si formohen sjellje të reja dhe duke përdorur idetë për të udhëhequr veprimet e tyre. Gjithashtu, sipas Bandurës, aftësitë sociale përfaqsojnë ato sjellje që krijohen duke u mbështetur në konceptet e të nxënit, dhe për dallim nga tiparet, janë të ndryshueshme përmes proceseve të të nxënit. Një ndër faktorët kryesor në formësimin e kompetencës sociale është ndërveprimi social (Shehu, 2021).

Ndërveprimet sociale janë mënyra si ne veprojmë dhe reagojmë ndaj atyre përreth nesh. Këto ndërveprime përfshijnë lëvizjet fizike (gjuhën e trupit), bashkëbisedimin, lojën së bashku, ndarjen e gjërave mes vete, bashkëpunimin, e shumë të tjera. Me dekada të tëra psikologët dhe sociologët kanë studiuar ndërveprimet sociale për të njohur më mirë sjelljen njerëzore dhe efektin që këto kanë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të fëmijës. Praktika e tregon se aspekti socio-emocional i zhvillimit të fëmijës zakonisht nënvlerësohet si nga prindërit, ashtu edhe nga sistemi arsimor, duke qenë se fokusi i tyre mbizotëron gjithmonë në aspektet e zhvillimit fizik/ shëndetësor të fëmijëve si dhe në zhvillimin kognitiv/mendor të tyre, posaqërisht në fëmijërinë e hershme. Prindërit dhe edukatorët kanë tendencë t'i japin përparësi stimulimit të fëmijës në aspektin kognitiv dhe përqëndrohen në arritjet e fëmijës krahas piketave zhvillimore fizike, motorike dhe kognitive (Shehu, 2021).

Ndërveprimi social është një nga faktorët më të rëndësishëm për shëndetin dhe zhvillimin e të gjithëve, nga fëmijët e vegjël e deri tek të moshuarit (Shehu, 2021). Fëmijët mësojnë aftësi sociale në kontekstin e marrëdhënieve të tyre, duke parë, duke imituar dhe duke iu përgjigjur sjelljeve sociale të të tjerëve, aftësitë sociale janë të lidhura ngushtë me familjen, kulturën dhe me përvojat paraprake të fëmijëve, gjithashtu fëmijët mësojnë më së shumti duke ndërvepruar. Fëmijët rriten dhe zhvillohen përmes ndërveprimeve sociale me bashkëmoshatarët dhe personat e tjerë në rrethin e tyre dhe këto marrëdhënie përfaqësojnë një aspekt jashtëzakonisht të rëndësishëm të zhvillimit social, emocional dhe njohës të fëmijëve, veçanërisht deri në moshën pesë vjeç (Xie, Li, Boucher, Hutchins, & Cairns, 2006). Gjatë marrëdhënieve shoqërore, fëmijët e vegjël ndikohen nga bashkëmoshatarët e tyre dhe ata vetë ndikojnë te bashkëmoshatarët e tyre dhe gjatë këtyre ndërveprimeve bëhen të dukshme rolet e tyre bartëse ose dominuese brenda rrethit shoqëror. Ndaj, edhe një nga detyrat kryesore zhvillimore të fëmijërisë së hershme është zotërimi i kompetencës sociale dhe kompetencës në marrëdhëniet sociale dhe shumë teori dhe hulumtime të fushës nxjerrin në pah rëndësinë e përvojave të hershme në fëmijëri për zhvillimin e mirëfilltë social të fëmijëve.

Ndërveprimet sociale pozitive kanë një gamë të gjerë të përfitimeve fizike dhe mendore, duke përfshirë aftësinë e rritur njohëse, shëndetin e mirë mendor, aftësitë e komunikimit, pavarësinë, shëndetin e përmirësuar fizik, etj, vlera këto qenësore për adaptim të suksesshëm të tyre në të ardhmen (Shehu, 2021). Ndërveprimi i hershëm social është veçanërisht i dobishëm për zhvillimin e fëmijëve dhe mjedisi i duhur mund t'i ndihmojë fëmijët të zhvillojnë aftësi të forta gjuhësore, kreativitet, ndjeshmëri, komunikim dhe besim- tipare.

2.5 KOMPETENCA SOCIALE

Zhvillimi social qëndron në themel të procesit përmes të cilit fëmija mëson të ndërveprojë me të tjerët, dhe si i tillë, nënkupton fitimin e përvojës në marrëdhëniet shoqërore dhe mësimin e përshtatjes me mjedisin përreth. Një nga detyrat kryesore të zhvillimit në fëmijëri është arritja e kompetencës në marrëdhëniet sociale, dhe shumë teori dhe studime kërkimore tregojnë se përvojat e fëmijërisë së hershme janë shumë të ndërlidhura me zhvillimin social të fëmijëve (Mulder, 2008). Kompetenca sociale është përcaktuar si aftësia për të përdorur burimet personale për të arritur një rezultat të dëshiruar social (Hussong, Zucker, Wong, Fitzgerald, & Puttler, 2005).

(Bierman, 2004) përcakton kompetencën sociale si aftësinë për të organizuar sjelljen shoqërore në kontekste të ndryshme shoqërore, në një mënyrë të dobishme për veten e tij dhe në përputhje me rregullat dhe moralin shoqëror. Sipas (Strickland, 2001), kompetenca sociale e fëmijëve është një proces themelor i zhvillimit që nënkupton zotërimin e aftësive dhe sjelljeve të nevojshme shoqërore, emocionale dhe njohëse që ata të përshtaten mirë me shoqërinë dhe të mbizotërojnë si një anëtar të suksesshëm të një shoqërie.

Kompetenca sociale përbëhet nga një morri shkathtësish sociale, emocionale, kognitive dhe sjelljore, të nevojshme për arritjen e qëllimeve personale dhe përshtatjen e suksesshme të individit në mjedis. Kompetenca sociale është baza mbi të cilën ndërtohen pritjet për ndërveprim me të tjerët në të ardhmen dhe mbi të cilën individët zhvillojnë perceptimet e sjelljes së tyre. Si e tillë, shpesh përfshin aftësitë sociale, komunikimin social dhe komunikimin ndërpersonal (Clikeman, 2007). Kompetenca sociale është një term që mbulon një llojllojshmëri të faktorëve të brendshëm dhe sjelljeve të jashtme që i ndikojnë gjasat dhe cilësinë e ndërveprimeve sociale të njeriut përgjatë jetës. Megjithatë, përjetohet nga vet fëmija, kompetenca sociale gjykohet nga të tjerët- nga

bashkëmoshatarët, mësimdhënësit dhe familjarët (Kennedy, 2018). Të qenit kompetent në aspekt social i ndihmon fëmijët të bashkëveprojnë në mënyra dhe kontekste të ndryshme dhe të ruajnë marrëdhëniet pozitive me moshatarët dhe të tjerët, të gjitha këto qenësore për suksesin e mëvonshëm në jetë dhe në punë.

Sipas Pedagogut (Vadahi, 2002) për të realizuar procesin e socializimit të fëmijeve është me rëndësi të krijohet një atmosferë e përshtatshme, pozitive, kreative etj. Edukimi social në institucione parashkollore është rezultat i organizimit të përgjithshëm të jetës dhe edukimit të parashkollorëve në përgjithësi, megjithatë edukimi social është i lidhur ngushtë edhe me personalitetin e edukatoreve.

Gjatë periudhës parashkollore, synohet t'u mundësohet fëmijëve të fitojnë aftësi sociale të cilat do t'i ndihmojnë ata të përshtaten me klasën dhe t'i përgatisin për jetën e tyre shoqërore. Përfitimi nga metodat bashkëpunuese të mësimdhënies në zhvillimin e aftësive sociale mbështet ndërveprimet e fëmijëve me njëri-tjetrin (Polat, Turker, & Akyol, 2022).

Zhvillimi social dhe emocional konsiderohet si një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës, veçanërisht duke pasur parasysh rëndësinë e tij në gatishmërinë e fëmijëve për shkollë. Zhvillimi social dhe emocional përbëhet nga marrëdhëniet që ka një individ me të tjerët, niveli i vetëkontrollit dhe motivimi dhe këmbëngulja që një person ka gjatë një aktiviteti (Shala, 2013). Shëndeti social-emocional i fëmijëve lidhet me përvojën e tyre dhe menaxhimin e emocioneve, me proceset e të mësuarit dhe me krijimin e marrëdhënieve (Kaushik, Kostaki, & Kyriakopoulos, 2016). Problemet social-emocionale gjatë fëmijërisë gjithashtu mund të çojnë në rezultate më të këqija arsimore dhe punësimi në moshën madhore të hershme (Jones, Greenberg, & Max, 2015).

Baza e cdo insitucioni parashkollor është që fëmijëve tu mundësojmë të zhvillojnë aftësi sociale dhe emocionale. Edukatorët mund të zhvillojnë mjaft mirë shëndetin social dhe emocional të fëmijeve duke përdorur libra për fëmijë, planifikim të aktiviteteve, lëvdata efektive, modelim i sjelljeve të duhura etj (Gordon & Browne, 2014). Nga hulumtimet që janë bërë në këtë fushë, gjejmë se programet e edukimit të fëmijërisë së hershme promovojnë në mënyrë efektive zhvillimin social të fëmijëve (Ren, 2024).

Shëndeti social dhe emocional i fëmijëve ndikon në zhvillimin e tyre për të nxënë. Fëmijët që kanë një mendje të shëndetshme, janë më të lumtur dhe kanë motivim më të madh për të nxënë, gjithashtu kanë një qëndrim më pozitiv ndaj shkollës, marrin pjesë me dëshirë në aktivitetet e klasës dhe tregojnë performancë të lartë akademike (Ho & Funk, 2018). Një periudhë e rëndësishme për zhvillimin e kompetencës sociale dhe të zhvillimit gjuhësor, padyshim se është fëmijëria e hershme. Publikimet e bëra kanë treguar se ekziston një lidhje pozitive në mes zhvillimit social dhe atij gjuhësor, zhvillimi i mirë gjuhësor e lehtëson zhvillimin e aftësive sociale tek fëmijët (Jurkic, Halliday, & Hascher, 2023). Pra, personaliteti i edukatoreve, përgatitja e tyre organizimi i veprimtarisë së edukimit parashkollor, metodologjia që vë fëmijën në qendër me veqoritë e tij të moshës dhe veqoritë individuale, ndikojnë në socializimin e fëmijëve.

2.6 RËNDËSIA E LOJËS NË ZHVILLIMIN E AFTËSIVE SOCIALE

Zhvillimi i lojës është një moment i rëndësishëm në fëmijërinë e hershme dhe asnjëherë nuk duhet të nënvlerësojmë se sa mëson fëmija gjatë lojës. Ajo që mund të na duket ne si një lojë e thjeshtë me lodra, në fakt është një ndërveprim që iu mëson fëmijëve një rang shkathtësisht nga ndarja e gjërave, të zgjidhja e konflikteve, ndërtimi i imagjinatës e ndërlidhja me personat tjerë rreth tyre. Në fëmijërinë e hershme loja përfaqëson kontekstin e të nxënës dhe shprehjes së sjelljes sociale. Në lojë mund të vëzhgojmë saktësisht se si një fëmijë inicon, mban dhe ruan nivelin e ndërveprimit dhe bashkëpunimit pozitiv si dhe se si i zgjidh konfliktet e dala nga loja. Secila nga këto komponente kërkon aftësi dhe kompetencë të veçantë sociale. Sipas (Kennedy, 2018), loja kërkon që fëmija të përdorë gjuhën sociale, të lexojë shenjat sociale, të demonstrojë inicim dhe reagim social, të shkëmbejë mendime dhe objekte, të negociojë role në lojë, të reagojë ndaj agresionit e konflikteve, të kërkojë ndihmë e të ndihmojë të tjerët, etj. Loja ka një rol vendimtar në ofrimin e një hapësire të sigurt, të kujdesshme, mbrojtëse, dhe argëtuese ku fëmijët mund të rikrijnë veten dhe përvojat e tyre përmes një procesi eksplorues. Përgjatë gjithë fëmijërisë së hershme, loja është një mënyrë e shkëlqyeshme që fëmijët të shprehin mendimet, emocionet, frikën dhe ankthet e tyre. Përmes lojës shfaqen edhe elementet e fantazisë e imagjinatës, si sjellje thelbësore që fëmija bën gjatë lojës së shtirur, fëmija mëson shkathtësi organizimi që e ndihmon atë të strukturojë lojën e shtirur në një histori dhe të përdorë arsyetimin shkaktues dhe mbi të gjithë fëmija ndihet rehat, ndjen lehtësi dhe kënaqësi gjatë angazhimit në lojë (Shehu, 2021).

Përpos përfitimeve të shumta në mbarë zhvillimin psiko-fizik të fëmijëve, në aspektin e zhvillimit social loja stimulon shkathtësitë e komunikimit, forcon empatinë dhe kompetencën sociale, ofron modele të ndërveprimit dhe platformë për ushtrimin e sjelljeve sociale dhe fuqizon të menduarit imagjativ dhe krijues. Loja ndihmon fëmijët të ndërtojnë një vlerë të vetes së tyre, duke i dhënë atyre një ndjenje të kompetencës dhe duke i bërë të ndihen mirë për veten, falë arritjeve në lojë (Shehu, 2021).

Loja sociale nënkupton ndërveprimin mes fëmijëve, lojërat në grup, veprimtaritë sportive, komunikimin gjatë lojës, lojën me role që lidhen me profesione të ndryshme dhe zhvillojnë marrëdhënie pozitive sociale ndërmjet fëmijëve. Ndërsa fëmijët përparojnë nëpër fazën e fëmijërisë së hershme, ata gjithashtu përparojnë nëpër disa faza të lojës josociale dhe sociale. Loja sociale është një tip loje që përfshin ndërveprimin e dy ose më shumë fëmijëve, si loja praktike ashtu edhe ajo imagjinare mund të jenë lojëra sociale nëse në to përfshihen më shumë se një fëmijë (Karaj, 2005)

Ndër funksionet e lojës për parashkollorët janë: shoqërimi me moshatarët, loja rrit mundësinë që fëmijët të shoqërohen me njëri tjetrin dhe të praktikojnë rolet që do të marrin përsipër në jetë. Clirimi apo shfryrja e tensionit, Frojdi dhe Eriksoni mendojnë se loja e lejon fëmijën që të shfryjë tensionet. Gjithashtu loja i ndihmon fëmijët në përmirësimin e zhvillimit kognitiv dhe të eksplorimit, Piazhëja mendonte se loja ndihmon në zhvillimin kognitiv të fëmijëve, sipas tij loja është një mjet ideal për të praktikuar strukturat kognitive të fëmijës (Karaj, 2005).

2.7 RËNDËSIA E MJEDISIT FIZIK NË ZHVILLIMIN E AFTËSIVE SOCIALE

Mjedisi fizik luan një rol të rëndësishëm në jetën e parashkollorëve dhe mund të jetë një komponent i rëndësishëm i përvojës dhe zhvillimit të fëmijëve kur është i organizuar me mençuri dhe i projektuar në mënyrë kuptimplotë. Organizimi i klasës rrit dhe mbështet para-aftësitë e fëmijëve për të kryer vetë veprimtari, për të nisur dhe përfunduar detyrat, krijon mundësi të zgjedhjeve dhe përgjegjësi të tyre të përcaktuara, gjithashtu ka rëndësi në bashkëpunimin më të lehtë me edukatorën dhe bashkëmoshatarët e tjerë dhe ndihmon në përmirësimin e aftësive njohëse të tij (Tadjic, Martinec, & Farago, 2015).

Një mjedis mësimor është ndarë në shumë karakteristika, të tilla si:

- mjedisi social/emocional,
- mjedisi i sjelljes,
- mjedisi fizik.

Mjedisi fizik në institucionet parashkollore ka një rol thelbësor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve. Një mjedis i pasur, i organizuar dhe i përshtatur sipas nevojave të moshës ndihmon në nxitjen e ndërveprimeve pozitive mes fëmijëve si dhe në formimin e aftësive si ndarja, bashkëpunimi dhe zgjidhja e konflikteve. Hapsirat që ofrojnë zona të ndryshme loje si: loja me role, këndi i ndërtimit apo këndi i leximit, krijojnë mundësi për bashkëveprim dhe komunikim natyral mes bashkëmoshatarëve. Këto zona janë të domosdoshme për të nxitur marrëdhënie sociale, pasi ato i ftojnë fëmijët të ndërveprojnë, të ndajnë përvoja dhe të mësojnë rregullat e jetës në komunitet (Curtis & O'Hagan, 2015).

Një mjedis fizik i organizuar mirë gjithashtu i jep fëmijëve ndjenjën e sigurisë dhe përkatësisë, duke ndikuar në mënyrë pozitive në vetëvlerësimin dhe sjelljen sociale të tyre. Kur fëmijët ndihen të sigurtë në një hapsirë që është e menduar për ta, ata janë më të prirur të eksplorojnë, të ndërtojnë marrëdhënie dhe të përfshihen në mënyrë aktive në lojë dhe bashkëbisedim (Bruce, 2011).

Sipas teorisë së zhvillimit social të Vygotsky-t, ndërveprimi social është një faktor kyq për zhvillimin kognitiv dhe emocional të fëmijëve. Mjedisi fizik si mbështetës i këtyre ndërveprimeve, ka një ndikim të drejtëpërdrejtë në mënyrën se si fëmijët mësojnë të ndërtojnë marrëdhënie, të kuptojnë emcionet e të tjerëve dhe të rregullojnë sjelljet e tyre në grup (Karaj, 2005).

Sipas (Ata, Akman, & Deniz, 2012), fëmijët parashkollorë janë në atë sistem në të cilin mjedisi është vetëm një nga shumë ndërveprues pedagogjik, socio-kulturor, kurrikular, motivues dhe socio-ekonomik. Vendosja efektive e të mësuarit është një kombinim i disa faktorëve të ndryshëm; hapësira e përshtatshme e përdorshme, zhurma, kushtet e ajrit, ngjyra dhe ndriçimi.

Një mjedis është një sistem i gjallë, në ndryshim. Më shumë se hapësira fizike, ajo përfshin mënyrën se si është strukturuar koha dhe rolet që pritët të luajmë. Ajo kushtëzon mënyrën se si ndihemi, mendojmë dhe sillemi dhe ndikon në mënyrë dramatike në cilësinë e jetës sonë. Mjedisi ose punon për ne ose kundër nesh ndërsa ne e bëjmë jetën tonë (Greenman, 1988).

Mjediset fizike luajnë një rol të rëndësishëm në sjelljet apo praktikat kulturore që ndodhin brenda tyre. Cilësia e mjedisit, prania e tij, gjendja dhe veçoritë e tij, si dhe prishja që pëson dhe nivelin në të cilin është ruajtur, janë të gjithë faktorë në cilësinë e aktiviteteve që zhvillohen në të. Specialistët e mjedisit dhe sjelljes kanë vënë re shqetësime të veçanta me tiparet e projektimit të këtyre parametrave që ndikojnë tek fëmijët shumë të vegjël, moshë e të cilëve do të thotë se kanë vëmendje shumë të shkurtër dhe janë lehtë të hutuar nga lëvizja vizuale dhe nga zhurma. Deri në moshën parashkollore supozohet se fëmijët shikojnë mjediset në mënyrë egocentrike, duke i lidhur ato vetëm me veten e tyre. Gradualisht, kjo mënyrë zëvendësohet nga një kornizë fikse e referencës në të cilën fëmija orientohe në mjedis në lidhje me disa pika referimi fikse (Ata, Akman, & Deniz, 2012). Mjediset mund të përcaktohen bazuar në objektivin e tyre, të vështirë dhe vetitë fizike të matshme. Aspektet specifike të mjedisit fizik përfshijnë: ndriçimin, zhurmën, ngjyrën dhe cilësinë e ajrit (Spivack, Askay, & Rogelberg, 2009).

2.7.1 Hapësira

Ambientet e brendshme dhe të jashtme duhet të jenë të rregulluara për të inkurajuar lloje të ndryshme të lojës që janë interesante, të sigurta, të përshtatshme dhe sfiduese për fëmijët. Duhet të lihet një hapësirë e përshtatshme për lojë. Ajo duhet të jetë mjaft e madhe që të lejojë aktivitetet e lira të një fëmije në lidhje me moshën dhe përparimin e tyre zhvillimor. Hapësira e lojës duhet të jetë e sigurt dhe duhet gjithashtu t'i mundësojë fëmijëve eksplorim dhe hetim. Krijimi i zonave publike dhe private në hapësirat e kujdesit për fëmijët është kompleks dhe duhet t'i kushtohet vëmendje e madhe aktivitetit në klasa. Zonat e aktivitetit motorik në të gjithë qendrën ose në grup mund të vendosen larg dhomave ku ndodhen foshnjat që flejnë. Mjedisi i papërshtatshëm mund të krijojë hapësira tepër të zhurmshme (Maxwell & Evans, 2000).

Fëmijët kanë nevojë për hapësirë ku mund të luajnë me të tjerët, por edhe hapësira më të vogla e të qeta për aktivitetin e tyre të vetmuar, ofrimin e mundësive për autonomi dhe pavarësi, por edhe një bazë të sigurt në të cilën ata mund të kthehen ose të tërhiqen, si dhe kur është e nevojshme. Vendet e brendshme dhe të jashtme janë të dyja të rëndësishme. Fëmijët kërkojnë aventura dhe sfida që të luajnë jashtë, ata eksplorojnë vende dhe kënaqen duke transformuar hapësirat për të krijuar një botë imagjinare (Tovey, 2007). Hapësira e brendshme duhet të jetë mjaft e madhe për të akomoduar një numër të dëshirueshëm të fëmijëve.

Zhurma është sigurisht vetëm një nga shumë faktorë që ndikojnë në klimën e klasës dhe disponimin e fëmijëve. Nga studimet e ndryshme zhurma në klasë ndahet në dy lloje apo kategori: 1. zhurma e krijuar nga aeroplanët dhe trafiku sipërfaqësor dhe gjithashtu qdo zhurmë tjetër që vë nga mjedisi i jashtëm jashtë klasës, 2. zhurma e brendshme e krijuar nga aktivitetet e përditshme të mësuesëve dhe nxënësve (Ata, Akman, & Deniz, 2012).

Studimet që janë bërë për mjedisin fizik theksojnë edhe rëndësinë dhe kushtet e ajrit për fëmijët parashkollorë. Fëmijëria e hershme është një fazë kur fëmijët nuk i kanë të zhvilluara shumë mirë mushkëritë dhe cilësia e ajrit që ata marrin në mjedisin ku ata kalojnë pjesën më të madhe të kohës duhet të jetë e nivelit të lartë. Kur fëmijët luajnë jashtë ata marrin më shumë ajër sesa të rriturit dhe mund të ekspozohen më shumë ndotjes së ajrit, fëmijët duhet të mbahen mbrenda kur cilësia e ajrit është e dobët, ose të paktën duhet të dekurajohen nga aktiviteti intensiv në natyrë. Cilësia e ajrit të brendshëm është po aq e rëndësishme sa ajo e ajrit të jashtëm, sepse fëmijët e kalojnë shumicën e kohës në kopsht apo shkollë në ambientin e mbyllur sesa jashtë (Ata, Akman, & Deniz, 2012).

Mjedisi fizik i pasur, i organizuar dhe i përshtatshëm për zhvillimin e hershëm është një faktor i rëndësishëm për formimin e aftësive sociale të fëmijët parashkollor. Ky mjedis ndikon jo vetëm në mënyrën se si fëmijët ndërveprojnë, por edhe në mënyrën se si ata ndërtojnë ndjenja pozitive për veten dhe të tjerët. Investimi në krijimin e hapsirave të menduara mirë është një investim në të ardhmen sociale dhe emocionale të fëmijëve.

KAPITULLI 3

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

3.1 Lloji dhe qasja e hulumtimit

Ky studim ndjek një model hulumtimi sasior apo kuantitativ, me një dizajn të hulumtimit përshkrues dhe eksplorues, që ka për synim të analizojë perceptimet e edukatoreve dhe të prindërve lidhur me ndikimin e edukimit parashkollor të institucionalizuar në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.

Përdorimi i metodës kuantitative është konsideruar i përshtatshëm për shkak të natyrës së të dhënave, të cilat janë mbledhur nëpërmjet pyetësorëve të strukturuar me pyetje të mbyllura dhe janë analizuar të dhënat e mbledhura, të cilat janë paraqitur në pjesën e fundit të punimit.

3.2 Pyetjet e hulumtimit

1. Cilat janë efektet e edukimit parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve?
2. Cili është roli i ndërveprimit me edukatoren dhe bashkëmoshatarët në procesin e zhvillimit të aftësive sociale?
3. Si e perceptojnë prindërit ndikimin e edukimit parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve të tyre?
4. Çfarë ndikimi ka mjedisi fizik dhe loja në ndërveprimin social të fëmijëve?

3.3 Hipotezat e hulumtimit

H1: Egzistojnë dallime në zhvillimin e aftësive sociale mes fëmijëve që vijnë edukimin parashkollor nga mosha 3 vjeç dhe atyre që ndjekin vetëm klasën përgatitore/parashkollore.

H2: Fëmijët që ndjekin edukimin parashkollor të institucionalizuar kanë aftësi më të zhvilluara sociale sesa fëmijët që nuk e ndjekin një institucion të tillë.

H3: Mjedisi fizik i përshtatshëm i klasës ndihmon në zhvillimin e aftësive më të mira sociale të fëmijëve.

H4: Loja e zhvilluar në institucione parashkollore ka një efekt të lartë në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.

H5: Ndërveprimi dhe bashkëpunimi i rregullt dhe pozitiv i edukatorëve dhe bashkëmoshatarëve, kontribuon në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.

H6: Prindërit e fëmijëve që ndjekin edukimin parashkollor të institucionalizuar, besojnë se këto institucione kanë ndikim pozitiv në zhvillimin social tek fëmijët e tyre.

3.4 Popullata dhe mostra e hulumtimit

Popullata e këtij hulumtimi përfshinë prindërit dhe edukatorët që punojnë në çerdhe/kopshte dhe edukatorët që punojnë në klasa parashkollore në kuadër të shkollave fillore.

Mostra e këtij hulumtimi është përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme dhe është përbërë prej 80 respondentëve, 30 edukatore dhe 50 prindër, ku pjesë e hulumtimit kanë qenë edukatorët të cilat punojnë në kopshte publike me fëmijë nga mosha (3-4, 4-5, 5-6) dhe gjithashtu edukatorët që punojnë me fëmijët (5-6 vjeç) në klasa parashkollore në kuadër të shkollave fillore publike në Komunën e Gjilanit. Gjithashtu pjesëmarrës në këtë hulumtim kanë qenë edhe prindërit e këtyre fëmijëve. Hulumtimi është realizuar në 5 shkolla fillore publike të komunës së Gjilanit të cilat janë: SHFMU “Selami Hallaçi”, SHFMU “Thimi Mitko”, SHFMU “Musa Zajmi”, SHFMU “Abaz Ajeti”, SHFMU “Rexhep Elmazi” dhe gjithashtu 2 institucione parashkollore të cilat janë: IP “Dardania” dhe IP “Integj”.

3.5 Instrumenti i mbledhjes së të dhënave

Instrumenti kryesor i përdorur për mbledhjen e të dhënave në këtë hulumtim ka qenë pyetësori i strukturuar, i hartuar në dy versione të veçanta: një për edukatorët dhe një për prindërit. Zgjedhja e pyetësorit si instrument i mbledhjes së të dhënave është mbështetur në qëllimin e studimit dhe pyetjet hulumtuese.

Pyetësi për edukatorët ka qenë i ndarë në 3 pjesë, ku ka eksploruar përvojat dhe praktikën që ato i kanë gjatë punës me fëmijë me theks në zhvillimin e aftësive sociale. Ndërsa pyetësi për prindërit ka përmbajtur dy pjesë, me pyetje të fokusuar në vlerësimin e përfitimeve që fëmijët kanë pasur nga edukimi parashkollor, përfshirë zhvillimin social, ndërveprimet me bashkëmoshatarët, përdorimin e teknologjisë, dhe rolin e edukatoreve në këtë proces.

Të dy versionet e pyetësit kanë përmbajtur kryesisht pyetje me alternativa të mbyllura, të formuluar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për të siguruar objektivitet dhe lehtësi në përgjigje dhe pastaj në analizim të të dhënave.

3.6 Procedura e analizës së të dhënave

Për realizimin e analizës së të dhënave në këtë studim, u ndoq një qasje sistematike dhe e strukturuar, që ka pasur për synim nxjerrjen e informacionit kuptimplotë nga përgjigjet e grumbulluara përmes dy pyetësorëve të ndarë sipas grupeve të synuara: edukatoreve dhe prindërve. Të dhënat u analizuan duke përdorur programin **Microsoft Excel**, i cili shërbeu si mjet për organizimin, përpunimin dhe paraqitjen vizuale të rezultateve.

Metoda e analizës së përdorur në këtë studim ishte analiza përshkuese-eksploruese, e cila ka për qëllim të japë një pasqyrë të qartë të shpërndarjes së përgjigjeve të pjesëmarrësve dhe të eksplorojë tendencat kryesore të të dhënave. Kjo metodë lejon përshkrimin numerik të fenomeneve të studiuara përmes përqindjeve, mesatareve dhe shpërndarjeve të thjeshta të të dhënave.

3.7 Etika e hulumtimit

Gjatë realizimit të këtij hulumtimi janë rrespektuar të gjitha parimet etike që lidhen me hulumtimin shkencor. Pjesëmarrësit janë informuar paraprakisht mbi qëllimin e hulumtimit dhe janë përfshirë në mënyrë vullnetare. Anonimiteti dhe konfidencialiteti i të dhënave janë ruajtur dhe të gjitha të dhënat e marra janë përdorur vetëm për qëllime hulumtimi.

3.8 INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË HULUMTIMIT

3.9 Rezultatet e të dhënave në formën tabelare dhe të figurave nga pyetësi i realizuar me Edukatorët.

PYETJET DEMOGRAFIKE

Institucioni	Numri i edukatoreve pjesëmarrëse
SHFMU “Selami Hallaçi”	6
SHFMU “Thimi Mitko”	6
SHMFU “Abaz Ajeti”	4
SHFMU “Musa Zajmi”	2
SHFMU “Rexhep Elmazi”	4
	Gjithsej: 22

Tabela 1. Numri i edukatoreve pjesëmarrëse në shkolla në hulumtim.

Në tabelën e paraqitur, janë listuar institucionet arsimore të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët (SHFMU) të cilët janë pjesëmarrës në hulumtim, së bashku me një tregues numerik për secilën shkollë të edukatoreve pjesëmarrëse në hulumtim.

Institucioni	Numri i edukatoreve pjesëmarrëse
IP “Dardania”	2
IP “Integj”	6
	Gjithsej: 8

Tabela 2. Numri i edukatorëve pjesëmarrëse në institucione parashkollore në hulumtim.

Në tabelën e paraqitur, janë listuar institucionet parashkollore, të cilat janë pjesëmarrës në hulumtim, së bashku me një tregues numerik për secilën institucion, pjesëmarrës në hulumtim.

1.Sa vite përvojë pune keni si edukatore?




Figura 1 . Analizimi i të dhënave të mbledhura për përvojën e edukatoreve.

Me anën e kësaj pyetje kemi arritur të kuptojmë përvojën profesionale të edukatoreve, duke vlerësuar se sa vite punojnë në këtë nivel arsimor.

Në grafikun më lartë janë paraqitur të dhënat e grumbulluara për një pasqyrim më të qartë të shpërndarjes së përvojës së tyre. Nga analizimi i rezultateve vërejmë se numri i edukatorëve me më shumë se 10 vite përvojë pune është 21 apo me një vlerë prej **70%**, duke u pasuar me edukatorët me 6 deri në 10 vite me 4 përgjigje apo **13%**. Ndërsa, me 2-5 vite me 3 përgjigje me **10%** dhe pak dallim nga kjo, me më pak se 2 vite me një numër prej 2 apo **7%**.

Nga këto të dhëna, është e qartë se shumica e edukatoreve kanë një eksperiencë të gjatë në mësimdhënie, më shumë se gjysma e tyre kanë mbi 10 vite përvojë pune profesionale.

2. Cili është niveli i arsimit tuaj?

Opsionet	Numri	Përqindja
a) Bachelor	26	87%
b) Master	4	13%
c) Doktoratë	0	0%

Tabela 3. Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për nivelin e arsimit të edukatoreve.

Kjo pyetje kishte për qëllim të evidentojë profilin arsimor të edukatoreve pjesëmarrës në studim, me qëllim që të kuptohet më mirë se si niveli i arsimit ndikon në perceptimet, qasjen dhe përfshirjen e tyre në proceset e zhvillimit social të fëmijëve.

Rezultatet tregojnë që: **87%** e edukatoreve që kanë qenë mostër e hulumtimit kanë përfunduar studimet Bachelor, duke treguar që ato kanë një formim të standardizuar profesional për punën me fëmijët në fushën e edukimit parashkollor.

13% kanë të përfunduar studimet Master, që tregon një përqindje të ulët të edukatorëve që kanë vazhduar me studime postdiplomike, çka mund të ndikojë në mënyrën si ata kontribuojnë në zhvillimin social të fëmijëve në mënyrë më të avancuar apo reflektive.

3.Ku e zhvilloni profesionin tuaj si Edukatore?




Figura 2. Analizimi i të dhënave të mbledhura mbi zhvillimin e profesionit të edukatoreve.

Figura më lartë na tregon se **73%** e edukatoreve punojnë në klasa parashkollore që funksionojnë brenda shkollave fillore. Kjo tregon se shumica e edukatoreve që janë anketuar janë të integruar në një mjedis shkollor formal, ku bashkëpunimi me mësuesit e arsimit fillor mund të ndikojë pozitivisht në tranzicionin dhe përgatitjen sociale të fëmijëve për fazat e ardhshme të shkollimit.

Ndërsa **27%** e edukatoreve punojnë në kopshte apo çerdhe, që janë mjedise më të fokusuara në kujdesin dhe zhvillimin e hershëm të fëmijëve. Në këto ambiente, zhvillimi social shpesh fokusohet në aspektet e ndërveprimit të hershëm, zhvillimin e gjuhës, ndjenjën e përkatësisë dhe rregullimin emocional.

4. Cila është grupmosha e fëmijëve me të cilët punoni?




Figura 3. Analizimi i të dhënave të mbledhura për identifikimin e grupmoshës së fëmijëve që punojnë edukatorët.

Kjo pyetje kishte për qëllim të identifikojë grupmoshën e fëmijëve me të cilët edukatorët e anketuara punojnë, me qëllim që të kuptohet më mirë konteksti zhvillimor në të cilin ata ushtrojnë ndikimin e tyre profesional. Nga të dhënat e mbledhura dhe të paraqitura në diagram rezulton se: 3 edukatore apo **10%** punojnë me grupmoshën 3–4 vjeç, 2 edukatore apo **7%** me grupmoshën 4–5 vjeç, ndërsa pjesa më e madhe, 25 edukatore apo **83%**, punojnë me fëmijë të moshës 5–6 vjeç. Gjatë kësaj moshe që përfshinë klasën përgatitore në kuadër të shkollave fillore apo institucioneve parashkollore, fëmijët fillojnë të ndërtojnë aftësi më të avancuara ndërpersonale, të kuptojnë dhe respektojnë rregullat sociale, të zhvillojnë empatinë, si dhe të marrin pjesë më aktivisht në marrëdhënie grupore.

Puna e edukatorëve në këtë fazë është thelbësore për përgatitjen e fëmijëve për shkollën fillore, veçanërisht përsa i përket aftësive sociale të cilat janë një komponent i rëndësishëm i zhvillimit të përgjithshëm të fëmijës. Për këtë arsye, kontributi i tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën si fëmijët ndërveprojnë me të tjerët, krijojnë ndjenja përkatësie dhe ndërtojnë identitetin e tyre social.

5. Sa fëmijë keni në grup/klasë parashkollore?

Opsionet	Numri	Përqindja
a) 0-10 fëmijë	1	3%
b) 11-15 fëmijë	1	3%
c) 16-20 fëmijë	12	40%
d) Më shumë se 20 fëmijë	16	53%

Tabela 4. Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për numrin e fëmijëve në grup/klasë parashkollore.

Kjo pyetje kishte për qëllim të identifikonte numrin e fëmijëve në grupet parashkollore ku edukatorët realizojnë aktivitetet e tyre. Ky informacion është i rëndësishëm për të kuptuar dinamikën e grupit dhe për të analizuar se si kjo ndikon në zhvillimin social të fëmijëve.

Nga të dhënat e mbledhura, rezultojmë se: **3%** e edukatoreve punojnë me grupe të vogla deri në 10 fëmijë, **3%** tjetër e edukatoreve punojnë me 11–15 fëmijë, **40%** e edukatoreve punojnë me grupe mesatare prej 16–20 fëmijë, Ndërsa **53%** e edukatoreve punojnë me grupe më të mëdha se 20 fëmijë.

Në këtë kontekst, mund të konstatojmë se shumica e edukatoreve të anketuara punojnë me grupe të mëdha, me mbi 20 fëmijë në klasë, duke e bërë menaxhimin e grupeve dhe zhvillimin social të fëmijëve një sfidë të rëndësishme. Punimi me grupe të tilla kërkon menaxhim të kujdesshëm të aktiviteteve dhe ndërveprimeve sociale mes fëmijëve, për të siguruar që secili të ketë mundësinë të zhvillohet në mënyrë të barabartë dhe të përfshihet në aktivitetet sociale.

Grupet më të vogla, nga ana tjetër, ofrojnë mundësi më të mëdha për edukatorët të investojnë në zhvillimin individual të fëmijëve dhe në ndihmën e ndërveprimeve sociale midis tyre. Pavarësisht kësaj, edhe punimi me grupe të mëdha mund të ketë avantazhe, si krijimi i mundësive për bashkëpunim dhe ndihmë reciproke mes fëmijëve, si dhe menaxhimi i marrëdhënieve sociale në një grup më të larmishëm.

PYETJE MBI NDIKIMIN E EDUKIMIT PARASHKOLLOR TË INSTITUCIONALIZUAR.

6. A mendoni se edukimi parashkollor i institucionalizuar ndihmon në zhvillimin e aftësive sociale?




Figura 4. Analizimi i të dhënave të mbledhura për ndihmën e edukimit parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.

Të dhënat tregojnë se **93%** e edukatorëve besojnë se edukimi parashkollor i institucionalizuar ndihmon shumë në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve, ndërsa **7%** e edukatorëve e konsiderojnë këtë ndihmesë si të konsiderueshme. Asnjë nga edukatorët e intervistuar nuk e ka vlerësuar ndikimin si "pak".

Këto përgjigjet tregojnë se edukatorët kanë një besim të fortë në rëndësinë e arsimit parashkollor institucional për formimin e aftësive sociale të fëmijëve. Ky besim është i justifikuar, pasi edukimi parashkollor ka një ndikim të konsiderueshëm në ndërveprimet sociale të fëmijëve, marrëdhëniet me bashkëmoshatarët dhe zhvillimin e aftësive të bashkëpunimit, ndarjes, dhe përgjegjësisë. Përmes aktiviteteve të drejtuara dhe mundësive për të luajtur në grupe, fëmijët kanë mundësinë të zhvillojnë shkathtësitë sociale që janë thelbësore për të ardhmen e tyre në shoqëri.

7. Në çfarë niveli ishin të zhvilluara aftësitë sociale të fëmijëve para fillimit të edukimit parashkollor të institucionalizuar?




Figura 5. Analizimi i të dhënave të mbledhura për nivelin e zhvillimit të aftësive sociale para vijimit të edukimit parashkollor.

Të dhënat e paraqitura në figurë tregojnë se asnjë edukatore nuk e ka vlerësuar se aftësitë sociale të fëmijëve ishin të zhvilluara në një nivel të lartë përpara fillimit të edukimit parashkollor të institucionalizuar, **30%** e edukatorëve vlerësuan aftësitë sociale të fëmijëve si të zhvilluara në një nivel mesatar, **70%** e edukatorëve vlerësuan aftësitë sociale të fëmijëve si të zhvilluara në një nivel të ulët para fillimit të edukimit parashkollor të institucionalizuar.

Në këtë pyetje nga të dhënat e mbledhura shohim se fëmijët para ndjekjes së edukimit parashkollor kanë një nivel më të ulët të zhvillimit të aftësive sociale, kjo lidhet në mënyrë indirekte me vërtetimin e hipotezës së parë **H1 të këtij hulumtimi**, e cila pohon se **egzistojnë dallime mes fëmijëve që kanë ndjekur edukimin parashkollor nga mosha 3 vjeç nga ata që po e vijnë vetëm klasën parashkollore 5-6 vjeç**, kjo është treguar nga përgjigjet e edukatoreve edhe në pyetje tjera në pyetësor.

Pjesa e përgjigjeve me 70% tregon se shumë fëmijë që vijnë në institucionet parashkollore kanë nevojë për mbështetje dhe orientim për të zhvilluar aftësitë e tyre sociale dhe për të mësuar si të ndërveprojnë me bashkëmoshatarët dhe të respektojnë rregullat sociale.

8. Pas një periudhe që fëmijët kanë ndjekur edukimin parashkollor, a keni vërejtur përmirësime në zhvillimin e aftësive sociale të tyre?




Figura 6. Analizimi i të dhënave të mbledhura për përmirësimet e aftësive sociale të fëmijëve.

Duke qenë se zhvillimi i aftësive sociale është një nga qëllimet kryesore të edukimit të hershëm, është me rëndësi të vlerësohet nëse ka pasur progres të dukshëm pas përfshirjes së fëmijëve në mjedisin parashkollor. Të dhënat në diagram tregojnë se të gjithë edukatorët e anketuar kanë vërejtur përmirësime të ndjeshme në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve pas ndjekjes së edukimit parashkollor: **63%** e edukatoreve tregojnë përmirësime shumë të mëdha, duke sugjeruar që ndikimi i edukimit parashkollor është i thellë dhe i dukshëm në sjelljen sociale të fëmijëve, **37%** e edukatoreve kanë vërejtur përmirësime të dukshme. Ky rezultat i paraqitur në diagramin lartë është shumë domethënës dhe tregon se edukimi parashkollor i institucionalizuar ka një efekt të drejtpërdrejtë dhe pozitiv në përmirësimin e aftësive sociale të fëmijëve.

Të dhënat e paraqitura në Figurën 6 konfirmojnë **vlefshmërinë e hipotezës së dytë të këtij hulumtimi**, e cila pohon se **fëmijët që ndjekin edukimin parashkollor kanë arritur të zhvillojnë aftësi më të mira sociale se fëmijët që nuk e ndjekin një edukim të tillë.**

9. Sa shpesh vëreni që fëmijët shfaqin aftësi për të bashkëpunuar, luajtur dhe ndarë lodrat me fëmijët e tjerë?




Figura 7. Analizimi i të dhënave të mbledhura për aftësitë e fëmijëve për të bashkëpunuar me fëmijët e tjerë.

Grafiku më lartë vizualizon të dhënat nga tabela. Ai përbëhet nga shtylla me ngjyra secila përfaqësuese e një përgjigje të dhënë nga edukatorët e anketuara.

Shiriti që përfaqëson “Shumë shpesh” është dukshëm më i gjatë, që tregon **70%** e edukatoreve kanë vërejtur që fëmijët shumë shpesh shfaqin sjellje bashkëpunuese dhe sociale gjatë aktiviteteve të përditshme, **27%** deklarojnë se kjo ndodh shpesh, ndërsa vetëm **3%** raportojnë se këto sjellje ndodhin ndonjëherë, asnjë edukatore nuk ka raportuar që këto sjellje ndodhin rrallë.

Këto të dhëna janë shumë të rëndësishme dhe tregojnë se aftësitë sociale të fëmijëve janë të zhvilluara në mënyrë të qëndrueshme në shumicën e grupeve të vëzhguara. Sjelljet si bashkëpunimi, ndarja e lodrave dhe loja në grup janë forma të natyrshme të ndërveprimit social pozitiv, që shërbejnë si tregues të zhvillimit të aftësive si empatia, ndjenja e përkatësisë dhe respektimi i të tjerëve.

10. Si ka ndikuar zhvillimi i aftësive sociale në zhvillimin gjuhësor dhe emocional të fëmijëve?




Figura 8. Analizimi i të dhënave të mbledhura për ndikimin e aftësive sociale në zhvillimin gjuhësor dhe emocional të fëmijëve.

Siç paraqitet edhe në diagramin ilustrues, të gjitha përgjigjet e edukatoreve tregojnë se zhvillimi i aftësive sociale ka një ndikim të drejtpërdrejtë dhe pozitiv në përparimin gjuhësor dhe emocional të fëmijëve.

- **43%** e edukatoreve mendojnë se ndikimi është i përgjithshëm pozitiv, duke nënkuptuar përmirësim të dukshëm në aftësinë për të komunikuar dhe shprehur ndjenja.
- **40%** theksojnë se ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes aftësive sociale dhe zhvillimit gjuhësor/emocional, duke vënë në dukje përparimet konkrete në këto fusha.
- **17%** raportojnë se zhvillimi i aftësive sociale ka përforcuar lidhjet emocionale dhe gjuhësore, pra ka rritur thellësinë e marrëdhënieve dhe të komunikimit ndërpersonal midis fëmijëve.

11. Cilat aftësi sociale mendoni se janë më të vështira për ti zhvilluar në moshën parashkollore?

Për të kuptuar më mirë sfidat që hasen në procesin e edukimit parashkollor në aspektin social, u paraqit pyetja e lartëcekur.

Opsionet	Numri	Përqindja
a) Ndërtimi i marrëdhënieve miqësore	5	16%
b) Zgjidhja e konflikteve në mënyrë paqësore	9	30%
c) Rendi dhe disiplina në grup/klasë	8	27%
d) Empatia dhe ndjeshmëria ndaj të tjerëve	8	27%

Tabela 5. Rezultatet e analizës së të dhënave për identifikimin e aftësive sociale që janë më të vështira për tu zhvilluar në moshën parashkollore.

Siç vërehet nga të dhënat në tabelë, aftësia më e vështirë për t'u zhvilluar, sipas mendimit të edukatoreve, është zgjidhja e konflikteve në mënyrë paqësore, me **30%** të përgjigjeve. Kjo përkon me sfidën që shumë fëmijë të moshës parashkollore përballen gjatë ndërveprimeve sociale, ku shpesh shfaqin sjellje impulsive, mungesë të kontrollit emocional dhe vështirësi në menaxhimin e situatave konfliktuale pa ndërhyrje të të rriturve.

Pas kësaj, rendi dhe disiplina në klasë **27%**, si dhe empatia dhe ndjeshmëria ndaj të tjerëve **27%**, janë gjithashtu të konsideruara si sfida të rëndësishme. Kjo sugjeron se zhvillimi i vetëkontrollit dhe ndjeshmërisë sociale kërkon kohë dhe përfshirje aktive nga edukatorët, përmes modelimit të sjelljeve të duhura dhe krijimit të situatave të strukturuar për të ushtruar këto aftësi.

Ndërtimi i marrëdhënieve miqësore, me vetëm **16%** të përgjigjeve, është vlerësuar si më pak sfiduese krahasuar me të tjerat.

12. Cilat aktivitete në kopsht/klasë parashkolllore mendoni se kontribuojnë më shumë në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve?

Opsionet	Numri	Përqindja
a) Lojërat me role	8	25%
b) Aktivitetet e lira	4	13%
c) Aktivitetet e strukturuara	2	9%
d) Bashkëveprimi me Edukatoren	4	13%
e) Bashkëveprimi direkt me bashkëmoshatarët	12	40%

Tabela 6. Rezultatet e analizës së të dhënave për aktivitetet në kopsht/ klasë që kontribuojnë më shumë në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.

Nga analiza e të dhënave rezulton se bashkëveprimi direkt me bashkëmoshatarët është vlerësuar nga **40%** e edukatorëve si faktori më ndikues në zhvillimin e aftësive sociale tek fëmijët. Kjo gjetje tregon se ndërveprimi natyror dhe spontan mes fëmijëve është faktori kryesor i zhvillimit social.

Këto të dhëna na tregojnë për **vlefshmërinë e hipotezës së tretë H3 të këtij hulumtimi, që pohon se ndërveprimi dhe bashkëpunimi i rregullt dhe pozitiv është një faktor më ndikues dhe që kontribuon në një shkallë më të lartë në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.**

Pas kësaj, lojërat me role janë vlerësuar nga **25%** e edukatoreve si mjaft të rëndësishme në zhvillimin social. Këto aktivitete përfshijnë imitimin e situatave të jetës reale dhe i japin fëmijës mundësinë të vendosë veten në pozitën e tjetrit, duke nxitur empatinë, kuptimin e roleve sociale dhe komunikimin.

Aktivitetet e lira me **13%**, si dhe bashkëveprimi direkt me edukatoren me **13 %**. Aktivitetet e strukturuara, si mësim apo ushtrime të drejtuara, janë vlerësuar nga vetëm **9%** e edukatoreve, çka tregon se zhvillimi social ndodh më shpesh në mënyrë spontane dhe përmes ndërveprimeve reale sesa në kushte të planifikuara formale.

PYTJET MBI MJEDISIN FIZIK DHE LOJËN

13. A e konsideroni të përshtatshëm dhe të dizajnuar mjedisin tuaj fizik në klasë, për të nxitur zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve?




Figura 9. Analizimi i të dhënave të mbledhura për dizajnimin e mjedisit fizik në klasë.

Figura më lartë paraqet se **33.3%** e edukatoreve e vlerësojnë mjedisin si shumë të përshtatshëm, çka tregon se në këto institucione janë të krijuara kushtet e nevojshme për ndërveprim social përmes hapësirave të organizuara mirë, qasjeje të lehtë në materiale, dhe zona bashkëpunuese për lojë e biseda, **26.7%** mendojnë se mjedisi është i përshtatshëm në një masë të konsiderueshme, duke sugjeruar se ndonëse janë përmbushur disa kushte bazë, ka ende vend për përmirësim në organizim apo pasurim të burimeve mësimore.

23.3% thonë se mjedisi mund të përmirësohet më shumë, ndërsa **16.7%** e konsiderojnë atë jo të përshtatshëm dhe me nevojë për ristrukturim, çka sinjalizon se në disa ambiente mungojnë elementët fizikë që favorizojnë ndërveprimin social, si ndarja e zonave për lojë në grup, vendosja fleksibile e mobilieve apo përdorimi i materialeve që nxisin bashkëpunimin.

Përgjigjet e dhëna nga edukatorët dhe të paraqitura në figurën më lartë, tregojnë se kemi një vërtetim të hipotezës së katërt **H4** të ngritur për këtë hulumtim, se mjedisi fizik i përshtatshëm në klasë ndihmon në zhvillimin e aftësive më të mira sociale të fëmijëve.

14. Sa janë të sigurt dhe stimuluese hapsirat e jashtme të mjedisit për zhvillimin e lojërave sociale?




Figura 10. Analizimi i të dhënave të mbledhura për sigurinë e hapsirave të jashtme për zhvillimin e lojërave sociale.

Grafiku i paraqitur me ngjyra dhe përqindje na tregon se **46.7%** e edukatoreve e konsiderojnë mjedisin e klasës si shumë të sigurt dhe shumë stimulues, kjo tregon prani të hapësirave të organizuara mirë, të pasura me materiale që nxisin eksplorimin, bashkëpunimin dhe zhvillimin social të fëmijëve. **43.3%** e vlerësojnë si mesatarisht të përshtatshëm, që tregon se ndonëse mjedisi përmbush një pjesë të standardeve të sigurisë dhe stimulimit, mund të ketë mungesa në pajisje, hapësira fleksibile apo organizim të brendshëm që e lehtëson lojën sociale dhe ndërveprimin. Ndërsa vetëm **10%** e edukatoreve mendojnë se mjedisi është pak i sigurt dhe pak stimulues, duke sinjalizuar që në disa institucione, fëmijët nuk kanë akses apo qasje në një mjedis që favorizon zhvillimin aktiv dhe të shëndetshëm të aftësive të tyre sociale.

15. Sa janë të përshtatshme materialet dhe paisjet që i keni në klasë për të nxitur lojëra sociale?




Figura 11. Analizimi i të dhënave të mbledhura për materialet dhe paisjet që nxisin lojëra sociale.

Rezultatet janë paraqitur në formë të një diagrami, që vizualizon ndarjen në përqindje të përgjigjeve të edukatoreve:

60% e edukatoreve deklaruan se materialet janë mesatarisht të përshtatshme, që përfaqëson pjesën më të madhe të diagramit dhe tregon një nivel të kënaqshëm, por jo të plotë të përmbushjes së nevojave.

36.7% i konsiderojnë ato shumë të përshtatshme, duke përfaqësuar gati një të tretën e përgjigjeve, çka tregon prezencën e klasave të mire pajisura ku loja sociale zhvillohet në mënyrë të efektshme.

3.3% (vetëm një edukatore) e vlerëson nivelin si pak të përshtatshëm, që përfaqëson një përqindje shumë të vogël të diagramit, por që gjithsesi tregon për ekzistencën e disa pengesave strukturore në ndonjë institucion të veçantë.

16. Sa të rëndësishme e konsideroni lojën për zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve?

Opsionet	Numri	Përqindja
a) Shumë të rëndësishme, pasi njerr në pah aftësitë e bashkëpunimit	26	87%
b) E rëndësishme	4	13%
c) Mesatarisht e rëndësishme	0	0%
d) Pak e rëndësishme	0	0%

Tabela 7. Rezultatet e analizës së të dhënave për rëndësinë e lojës në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.

Nga interpretimi i tabelës vërehet se 26 nga 30 edukatore **87%** vlerësojnë lojën si shumë të rëndësishme, duke theksuar rolin që ajo ka në formimin e aftësive sociale si bashkëpunimi, ndarja, ndërveprimi dhe komunikimi. **Kjo përqindje tregon vlefshmërinë e hipotezë së pestë H5, ku pohon se loja konsiderohet si shumë efektive për zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.** Loja shihet jo vetëm si argëtim, por edhe si një mekanizëm natyror përmes të cilit fëmijët mësojnë të ndërveprojnë me të tjerët dhe të përfshihen në situata që kërkojnë respektimin e rregullave dhe roleve të ndryshme sociale, kurse 4 edukatore apo **13%** e kanë vlerësuar lojën si “të rëndësishme”, duke pohuar vlerën e saj, megjithatë pa e renditur si faktor kryesor. Vlen të theksohet se nuk ka pasur asnjë përgjigje që e konsideron lojën mesatarisht apo pak të rëndësishme, gjë që tregon konsensus të plotë mbi ndikimin pozitiv të saj në zhvillimin shoqëror të fëmijëve.

17. Cilat lloje të lojës mendoni se kanë ndikim më të madh në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve?




Figura 12. Analizimi i të dhënave të mbledhura për llojet e lojës më ndikim më të lartë në zhvillimin e aftësive sociale.

Nga të dhënat e paraqitura në diagramin rrethor vërehet se lojërat e lira zënë përqindjen më të madhe të përgjigjeve **40%**, çka tregon besimin e lartë të edukatorëve në ndikimin e tyre në zhvillimin spontan të marrëdhënieve sociale. Lojërat e lira u japin fëmijëve mundësinë të eksplorojnë, të marrin iniciativa dhe të bashkëveprojnë në mënyrë të natyrshme me bashkëmoshatarët e tyre.

Pas tyre renditen lojërat me role **23%**, të cilat ndihmojnë fëmijët të kuptojnë ndjenjat e të tjerëve, të shfaqin empati dhe të ushtrojnë sjellje shoqërore në situata të imituara. Këto lloj lojërash ndihmojnë në zhvillimin emocional dhe ndërpersonal. Lojërat me rregulla janë përzgjedhur nga **17%** e edukatorëve, duke nënvizuar rëndësinë e respektimit të strukturës, rregullave dhe radhës në ndërtimin e sjelljes sociale të qëndrueshme. Lojërat kolektive dhe ato në grupe të vogla, me përkatësisht **13%** dhe **7%**, gjithashtu vlerësohen për ndikimin që kanë në forcimin e ndjenjës së përkatësisë dhe ndihmën në integrimin social të fëmijëve në dinamika grupore.

3.10 Rezultatet e të dhënave në formën tabelare dhe të figurave nga pyetësi i realizuar me Prindërit.

Institucioni	Numri i prindërve pjesëmarrës
SHFMU “Selami Hallaçi”	10
SHFMU “Thimi Mitko”	0
SHMFU “Abaz Ajeti”	0
SHFMU “Musa Zajmi”	10
SHFMU “Rexhep Elmazi”	0
	Gjithsej: 20

Tabela 8. Numri i prindërve pjesëmarrës në shkolla.

Në tabelën 8 është paraqitur numri i prindërve pjesëmarrës në hulumtim në shkolla, që ka qenë gjithsej 20 prindër.

Institucioni	Numri i prindërve pjesëmarrës
IP “Dardania”	15
IP “Integj”	15
	Gjithsej: 30

Tabela 9. Numri i prindërve pjesëmarrës në institucione parashkollore.

Në tabelën 9 është paraqitur numri i prindërve pjesëmarrës në hulumtim në insitucione parashkollore, që ka qenë gjithësej 30 prindër.

PYETJET DEMOGRAFIKE

1. Gjinia e prindit?




Figura 13. Analizimi i të dhënave të mbledhura për gjininë e prindërve, pjesëmarrës në hulumtim.

Nga të dhënat e mbledhura rezulton se numri i prindërve femra është më i lartë se ai i prindërve meshkuj, ku femrat përbëjnë shumicën e pjesëmarrësve në studim me 39 apo **78%** të paraqitur në diagramin më lartë, kurse meshkujt përbëjnë një numër prej 29 apo **22%** pjesëmarrësve.

Ky rezultat është në përputhje me prirjet e përgjithshme që vërehen në shumicën e studimeve të ngjashme, ku nënat janë më të pranishme në komunikim me institucionet edukative dhe më të angazhuara në çështje që lidhen me zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve.

Interpretimi i këtyre rezultateve ndihmon në vlerësimin e ndikimit të gjinisë në faktorë të të ndryshëm të studimit dhe në përjasjen e analizës me një qasje të balancuar gjinore.

2. Moshë e fëmijës?




Figura 14. Analizimi i të dhënave të mbledhura për moshën e fëmijës.

Pyetja mbi moshën e fëmijëve synoi të identifikojë grupmoshat që ndjekin institucionet parashkollore dhe të ndihmojë në analizën e nivelit të zhvillimit social në raport me fazat kryesore të zhvillimit të hershëm. Këto të dhëna të paraqitura në diagramin e mësipërm janë të rëndësishme, pasi aftësitë sociale zhvillohen gradualisht dhe janë të ndikuara nga moshë dhe përvoja sociale që fëmijët fitojnë në institucionet edukative.

Nga të dhënat e mbledhura vërehet se **70%** e fëmijëve janë në grupmoshën 5–6 vjeç, që përfaqëson periudhën përgatitore për kalimin në arsimin fillor. Kjo është një moshë ku pritet që aftësitë sociale të jenë më të zhvilluara, falë përvojës së mëparshme në institucion dhe ndërveprimit të vazhdueshëm me bashkëmoshatarët dhe edukatorët, **22%** e fëmijëve janë në moshën 4–5 vjeç, një fazë ku fëmijët fillojnë të ndërtojnë marrëdhënie më të qëndrueshme shoqërore, ku shfaqen më shumë ndjeshmëria, ndarja dhe rregullat në lojëra. Vetëm **8%** e fëmijëve janë në grupmoshën 3–4 vjeç, e cila përfaqëson fillimin e pjesëmarrjes në mjediset edukative jashtë shtëpisë. Në këtë periudhë, ndërveprimi social është ende në fazën e hershme dhe më shumë i lidhur me ndjekjen e shembujve dhe imitimin e sjelljeve.

3. A jeni i punësuar?

Opsionet	Numri	Përqindja
a) Po	36	72%
b) Jo	14	28%

Tabela 10. Rezultatet e analizës së të dhënave për punësimin e prindërve.

Në kuadër të të dhënave demografike, pyetja: “**A jeni i punësuar?**”, ka pasur për qëllim të kuptojë statusin ekonomik dhe angazhimin profesional të prindërve pjesëmarrës. Kjo është një e dhënë me rëndësi, pasi statusi i punësimit mund të ndikojë në mënyrën se si prindërit përfshihen në zhvillimin dhe edukimin social të fëmijëve të tyre, si dhe në bashkëpunimin me institucionet parashkollore.

Nga të dhënat vërehet se **72%** e prindërve janë të punësuar, ndërsa **28%** nuk janë në marrëdhënie pune. Kjo shpërndarje tregon se një pjesë e konsiderueshme e prindërve është aktive në tregun e punës, gjë që mund të ndikojë në mënyrën se si e menaxhojnë kohën dhe përfshirjen në jetën sociale dhe edukative të fëmijës.

Fakti që mbi një e katërta e prindërve janë të papunë është gjithashtu domethënëse, pasi këta prindër potencialisht mund të kenë më shumë kohë për të qenë të pranishëm në zhvillimin ditor të fëmijës, përfshirë edhe aspektet sociale të tij.

4. Ku vijon fëmija juaj edukimin parashkollor të institucionalizuar?




Figura 15. Analizimi i të dhënave të mbledhura për llojin e vijimit të edukimit parashkollor të fëmijëve.

Të dhënat e mbledhura në figurën më lartë na paraqesin numrin dhe përqindjen e prindërve që kanë qenë pjesëmarrës në hulumtim dhe që kanë treguar se ku i kanë dërguar fëmijët e tyre për ndjekjen e edukimit parashkollor të institucionalizuar, kjo pyetje është drejtuar prindërve për arsye se krahasimi mes fëmijëve që vijnë në edukimin parashkollor në kopsht/ çerdhe dhe atyre që vijnë në klasën parashkollore në kuadër të shkollave fillore ka qenë edhe qëllim i këtij hulumtimi.

Nga këto të dhëna shohim se nga 50 prindër pjesëmarrës në hulumtim 30 nga ta apo **60%** i kanë dërguar fëmijët e tyre në institucione parashkollore që përfshijnë kopsht/ çerdhe, kurse 20 nga ta apo **40%** në klasa parashkollore në kuadër të shkollave fillore.

5. Cila është arsyeja që e keni dërguar fëmijën në kopsht/çerdhe, apo klasë parashkollore?

Opsionet	Numri	Përqindja
a) Puna, mungesa e mundësive për edukim në shtëpi	17	35%
b) Kujdesi dhe siguria	9	19%
c) Zhvillimi social i fëmijës	15	30%
d) Përgatitja për shkollën	8	16%

Tabela 11. Rezultatet e analizës së të dhënave për arsyen e dërgimit të fëmijëve në edukimin parashkollor të insitucionalizuar.

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur të që na tregojnë se **35%** e prindërve kanë theksuar se puna dhe mungesa e mundësive për edukim të fëmijëve të tyre në shtëpi ishin arsyet kryesore për dërgimin e fëmijës në institucione parashkollore. Ky faktor është shumë i rëndësishëm, pasi sugjeron se një numër i konsiderueshëm prindëresh e shohin si një nevojë të domosdoshme për t'u siguruar që fëmijët të kenë mundësi për zhvillim dhe kujdes në një ambient të sigurt dhe stimulues, sidomos kur ata vetë janë të angazhuar në punë. Ndërsa **30%** e prindërve e theksojnë **zhvillimin social të fëmijës** si arsye për dërgimin në institucionin parashkollor, kjo është një pasqyrë e qartë e interesit të prindërve për promovimin e aftësive sociale dhe ndërveprimit me fëmijët e tjerë.

19% e prindërve theksojnë se kujdesi dhe siguria janë arsyeja kryesore për të dërguar fëmijët në institucione parashkollore.

Më pas, **16%** e prindërve janë të fokusuar në përgatitjen e fëmijëve për shkollën, që është një tjetër motiv i rëndësishëm që lidhet me përgatitjen e fëmijës për sfidat që do të hasë në shkollën fillore, duke u siguruar që ata të kenë një bazë të fortë edukative dhe sociale.

Këto rezultate mund të themi se janë paraqitur kështu edhe për arsyen se kemi një numër më të madh të prindërve që fëmijët e tyre vijonë insitucionin parashkollor si cerdhe/kopsht të cilët janë përfshirë në hulumtim.

PËRCEPTIMET E PRINDËRVE MBI NDIKIMIN E EDUKIMIT PARASHKOLLOR TË INSTITUCIONALIZUAR

6. Si ka ndikuar edukimi parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijës tuaj?




Figura 16. Analizimi i të dhënave të mbledhura për ndikimin e edukimit parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.

Kjo pyetje kishte për qëllim të vlerësonte perceptimin e prindërve mbi efektin që edukimi parashkollor i institucionalizuar ka pasur në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve të tyre. Rezultatet tregojnë një prirje shumë pozitive në vlerësimin e ndikimit të edukimit parashkollor institucional në aspektin social të zhvillimit të fëmijëve, ku sipas rezultateve të paraqitura në tabelë shohim se: **76%** e prindërve e kanë vlerësuar ndikimin si të lartë, gjë që sugjeron një besim të fortë në rolin e institucioneve parashkollore në ndërtimin e zhvillimit të aftësive sociale të fëmijëve të tyre. Ndërsa **24%** e prindërve e kanë vlerësuar ndikimin si mesatar, kjo mund të pasqyrojë dallime në mënyrën se si fëmijët përshtaten me edukimin parashkollor, mjedisin edukatorën dhe bashkëmoshatarët.

Nga të dhënat më lartë shohim se është vërtetuar edhe hipoteza e gjashtë **H6** e ngritur për këtë hulumtim, ku është cekur se prindërit e fëmijëve që ndjekin edukimin parashkollor të institucionalizuar, besojnë se këto institucione kanë ndikim pozitiv në zhvillimin e aftësive sociale të tyre.

7. Në çfarë niveli mendoni se edukimi parashkollor i ka ndihmuar fëmijës tuaj të zhvillojë aftësi më të mira sociale dhe sjellje pozitive në klasë dhe në mjedise tjera?




Figura 17. Analizimi i të dhënave të mbledhura për nivelin e zhvillimit të aftësive sociale të fëmijëve.

Sipas të dhënave të mbledhura nga prindërit e anketuar në këtë hulumtim rezultojmë se: **54%** e prindërve kanë vlerësuar ndikimin e edukimit parashkollor si të lartë, ndërsa **34%** e konsiderojnë këtë ndikim si shumë të lartë, gjë që e çon përqindjen totale të vlerësimeve pozitive në **88%**. Ky rezultat përforcon faktin se prindërit e shohin edukimin parashkollor të insitucionalizuar si një faktor kyç në zhvillimin e aftësive sociale dhe të sjelljeve pozitive të fëmijëve.

Vetëm **12%** kanë vlerësuar ndikimin si mesatar, ndërsa asnjë nga prindërit nuk e ka konsideruar ndikimin si të ulët. Kjo tregon një besim të lartë të komunitetit prindërv në rolin e institucioneve parashkollore si nxitës të sjelljeve të dëshiruara në grup, në klasë dhe në mjedise të tjera sociale.

Ky rezultat përputhet me literaturën shkencore që thekson se edukimi i hershëm, kur është i strukturuar dhe i orientuar drejt zhvillimit shoqëror dhe emocional, kontribuon ndjeshëm në ndërtimin e kompetencave sociale që janë të rëndësishme për jetën e përditshme të fëmijëve.

8. Sa shpesh flisni me fëmijën tuaj për rëndësinë e sjelljes pozitive?




Figura 18. Analizimi i të dhënave të mbledhura për rëndësinë e sjelljes pozitive të fëmijëve.

Sjellja pozitive në moshën parashkollore ka të bëjë me atë se si fëmijët ndërveprojnë me të tjerët në mënyrë të respektueshme, të sjellshme dhe bashkëpunuese. Kjo përfshin aftësinë për të ndarë lodrat, për të pritur radhën, për të shprehur ndjenjat në mënyrë të përshtatshme, për të ndjekur udhëzimet e edukatorës dhe për të ndërtuar marrëdhënie miqësore me bashkëmoshatarët. Sjellja pozitive shfaqet gjithashtu në përpjekjet për të zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore dhe në respektimin e rregullave të klasës apo të lojës. E gjithë kjo sjellje varet shumë edhe nga puna dhe angazhimi që e bëjnë prindërit me fëmijët e tyre për të kultivuar këtë sjellje tek fëmijët.

80% e prindërve deklarojnë se flasin shumë shpesh me fëmijën e tyre për rëndësinë e sjelljes pozitive, ndërsa **20%** e bëjnë këtë shpesh. Vlen të theksohet se asnjë prind nuk ka zgjedhur alternativat "ndonjëherë" ose "rrallë", gjë që reflekton një angazhim të qëndrueshëm dhe të vetëdijshëm të prindërve në formimin social të fëmijëve.

9. A keni vërejtur përmirësime të fëmija juaj në zhvillimin e aftësive sociale si: ndihma ndaj bashkëmoshatarëve, bashkëpunimi, empatia(bashkëndjesia)?

Opsionet	Numri	Përqindja
a) Përmirësime të shkëlqyera	30	60%
b) Përmirësime të kënaqshme	14	28%
c) Përmirësime mesatare	6	12%
d) Përmirësime minimale	0	0%

Tabela 12. Rezultatet e analizës së të dhënave për përmirësimin e zhvillimit të aftësive sociale të fëmijëve.

Kjo pyetje ka pasur për qëllim të identifikojë përceptimin e prindërve mbi ndikimin e edukimit parashkollor institucional në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijës së tyre, me fokus në komponentët kryesorë si ndihma ndaj të tjerëve, bashkëpunimi dhe empatia.

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 12 tregojnë se shumica e prindërve, përkatësisht **60%**, kanë vërejtur përmirësime të shkëlqyera në këto aftësi sociale, ndërsa **28%** i kanë vlerësuar si përmirësime të kënaqshme. Vetëm **12%** kanë vlerësuar përmirësimet si mesatare dhe asnjë prind nuk ka raportuar përmirësime minimale, gjë që e bën këtë një tregues shumë të qartë për ndikimin pozitiv të edukimit parashkollor të institucionalizuar. Këto të dhëna sugjerojnë se institucionet parashkollore luajnë një rol të rëndësishëm në përvetësimin e sjelljeve sociale pozitive. Në mënyrë të veçantë, përmes lojërave, aktiviteteve të përbashkëta dhe ndërveprimeve të përditshme, fëmijët mësojnë të bashkëpunojnë, të ndihmojnë të tjerët dhe të tregojnë ndjeshmëri apo aftësi thelbësore për integrimin e tyre në grup dhe në shoqëri në përgjithësi.

10. Sa të kënaqur jeni me qasjen e edukimit parashkollor për zhvillimin e aftësive sociale të fëmijës tuaj?




Figura 19. Analizimi i të dhënave të mbledhura mbi kënaqësinë e prindërve për qasjen e edukimit parashkollor të insitucionalizuar.

Qëllimi i kësaj pyetje drejtuar prindërve të anektuar ishte të vlerësonte nivelin e kënaqësisë së prindërve lidhur me mënyrën si institucionet parashkollore po kontribuojnë në zhvillimin social të fëmijëve të tyre.

Rezultatet në figurën 19, tregojnë se një shumicë dominuese, përkatësisht **70%** e prindërve janë shumë të kënaqur me qasjen që ndjekin institucionet parashkollore për zhvillimin e aftësive sociale. Ndërkohë, **22%** janë të kënaqur dhe vetëm **8%** kanë shprehur një nivel mesatar kënaqësie, ndërsa asnjë nga të anketuarit nuk është shprehur i pakënaqur.

Këto të dhëna flasin për një përceptim shumë pozitiv të prindërve ndaj ndikimit të edukimit parashkollor të insitucionalizuar në formimin shoqëror të fëmijëve të tyre. Prania e edukatoreve të kualifikuara, aktivitetet e ndryshme dhe një mjedis i mirë organizuar, duket se janë faktorë që kontribuojnë ndjeshëm në kënaqësinë prindërore.

11. Cilat aktivitete në edukimin parashkollor mendoni se kontribuojnë më shumë në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijës tuaj?




Figura 20. Analizimi i të dhënave të mbledhura për aktivitetet që kontribuojnë më shumë në zhvillimin e aftësive sociale.

Synimi i kësaj pyetje ishte që të shohim përciptimin e prindërve për efektivitetin e llojeve të ndryshme të aktiviteteve në edukimin parashkollor, në funksion të zhvillimit të aftësive sociale të fëmijës.

Sipas të dhënave në figurën 16, prindërit theksojnë më së shumti rëndësinë e aktiviteteve të lira **36%** dhe lojërave me role **30%**, të cilat shihen si mjedise të pasura për nxitjen e ndërveprimit social, marrjen e roleve dhe zhvillimin e empatisë. Ndërkohë, bashkëveprimi me bashkëmoshatarët është përmendur nga **22%** e prindërve, si një faktor kyç për të mësuar sjellje sociale si ndarja, pritja e radhës dhe zgjidhja e konflikteve.

Aktivitetet e strukturuar dhe bashkëveprimi me edukatorën janë përmendur më pak, me përkatësisht **4%** dhe **8%**. Edhe ato gjithashtu kanë rol në formësimin e sjelljes së fëmijëve, por ndoshta perceptohen si më të kufizuara në spontanitet dhe ndërveprim të lirë.

12. Sa kohë në ditë i kalon fëmija juaj duke përdorur paisjet teknologjike, si: Ipad/Tablet, telefon, lojëra me kompjuter etj?

Opsionet	Numri	Përqindja
a) 3 orë e më shumë	2	4%
b) 2 orë	21	42%
c) 1 orë	15	30%
d) Më pak se 1 orë	12	24%

Tabela 13. Rezultatet e analizës së të dhënave për përdorimin e pasijeve teknologjike të fëmijëve.

Zhvillimet e teknologjisë viteve të fundit dhe ndikimi nga paisjet teknologjike është i pamshangshëm në jetën e secilit individ, e gjithashtu edhe krijimi i varësisë ndaj saj. Ky ndikim dhe kjo varësi paraqitet edhe tek të vegjëlit tanë, sepse secili fëmijë sot ka qasje në përdorimin e paisjeve teknologjike, duke filluar nga mosha e hershme e fëmijëve. Duke u bazuar në këtë gjendje faktike dhe që lidhet drejtëpërdrejtë me aftësitë sociale të fëmijëve ishte e domosdoshme që në huumtimin për zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve të përfshihej edhe një pyetje për përdorimin e teknologjisë nga ana e fëmijëve. Kjo për arsye se kur fëmijët kalojnë shumë kohë pranë ekranit ata janë të mbyllur dhe nuk zhvillojnë asnjë aftësi sociale me familjen, rrethin apo të tjerët. Nga rezultatet e analizës të paraqitur në tabelën 13 shihet se pjesa më e madhe e prindërve **42%** raportojnë se fëmijët e tyre kalojnë mesatarisht 2 orë në ditë duke përdorur pajisje teknologjike. Pas tyre vijnë ata që raportojnë 1 orë në ditë me **30%** dhe më pak se 1 orë **24%**. Vetëm një përqindje e vogël, **4%**, e fëmijëve përdorin teknologjinë për 3 orë ose më shumë çdo ditë.

Këto të dhëna mud të themi se tregojnë një përdorim të “moderuar” të teknologjisë nga shumica e fëmijëve, por edhe tregon rëndësinë e monitorimit të kohës së kaluar para ekranit. Duke marrë parasysh që rekomandimet ndërkombëtare sugjerojnë kufizimin e përdorimit të pajisjeve teknologjike për fëmijët, këto të dhëna janë të rëndësishme për të vlerësuar nevojën për ndërhyrje apo udhëzime për prindërit, sepse mosha që ndodhen këta fëmijë nuk është në përputhje me numrin e orëve që këta fëmijë i kalojnë para ekranit.

13. A mendoni se edukimi parashkollor e ka ndihmuar fëmijën tuaj të përgatitet për marrëdhëniet sociale në shkollën fillore dhe mjedise tjera jashtë shkollës?




Figura 21. Analizimi i të dhënave të mbledhura për ndihmën e edukimit parashkollor për marrëdhëniet sociale në shkollë fillore dhe mjedise tjera?

Një pyetje tjetër e rëndësishme në anketën tonë ka të bëjë me ndikimin e edukimit parashkollor në përgatitjen e fëmijëve për marrëdhëniet sociale, si në shkollën fillore ashtu edhe në mjedise të tjera jashtë shkollës.

Nga rezultatet e paraqitura në figurën 17, na tregojnë se: **62%** e prindërve vlerësojnë ndikimin e edukimit parashkollor si shumë të mirë, duke sugjeruar se shumica e fëmijëve kanë përfituar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e aftësive të tyre sociale gjatë kësaj periudhe, **25%** e prindërve tjerë e vlerësojnë këtë ndikim si të mirë, ndërsa një përqindje më e vogël **10%** e konsideron ndikimin si mesatar. Nuk ka asnjë prind që ka raportuar ndikim minimal në këtë aspekt.

14. Si e vlerësoni punën e edukatoreve në ndihmën e fëmijës tuaj për të zhvilluar aftësi sociale?




Figura 22. Analizimi i të dhënave të mbledhura për vlerësimin e punës së edukatoreve në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.

Të dhënat në diagramin e mësipërm rezultojnë se **78%** e prindërve e vlerësojnë punën e edukatoreve si shumë të shkëlqyeshme për ndihmën që ato ofrojnë në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve. Ky rezultat sugjeron një nivel të lartë kënaqësie dhe besimi të prindërve në aftësinë e edukatoreve për të mbështetur fëmijët në krijimin e marrëdhënieve të shëndetshme sociale dhe për të zhvilluar aftësi sociale të qëndrueshme. Pjesa tjetër e prindërve, **20%**, e vlerëson punën e edukatoreve si të kënaqur, duke treguar se edhe pse ka një nivel të lartë besimi dhe vlerësimi, gjithsesi mund të ketë aspekte të cilat mund të përmirësohen për të arritur një nivel optimal të mbështetjes për zhvillimin social të fëmijëve, ndërsa vetëm **2%** e prindërve e kanë vlerësuar punën e edukatoreve si mesatare dhe asnjë prind nuk ka shprehur mospajtimin me punën e edukatoreve, duke vlerësuar ndihmën si jo të kënaqshme.

Këto rezultate janë tregues i qartë i përkushtimit dhe efikasitetit të edukatoreve në mbështetje të zhvillimit social të fëmijëve, dhe sugjerojnë që puna e tyre është e njohur dhe e vlerësuar në mënyrë pozitive nga shumica e prindërve. Ky nivel i lartë i kënaqësisë është gjithashtu një tregues i suksesit të metodave dhe praktikave të përdorura nga edukatorët në mjedisin parashkollor për të stimuluar zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.

3.11 PËRFUNDIMET

Edukimi parashkollor i institucionalizuar përfaqëson një faktor të rëndësishëm në ndërtimin e themeleve të zhvillimit të aftësive sociale të fëmijëve në fazat e hershme të jetës. Gjetjet e këtij hulumtimi konfirmojnë se përfshirja e hershme dhe afatgjatë e fëmijëve në institucione parashkollore ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e aftësive sociale si: bashkëpunimi, komunikimi, empatia, vetëkontrolli dhe zgjidhja e konflikteve. Rezultatet e hulumtimit, të mbledhura përmes anketimit të edukatorëve dhe prindërve, treguan se:

- **Fëmijët që kanë ndjekur edukimin parashkollor të institucionalizuar nga moshë 3 deri në 6 vjeç** tregojnë një nivel më të lartë të zhvillimit social në krahasim me ata që kanë ndjekur vetëm klasën përgatitore në moshën 5-6 vjeç.
- **Mjedisi fizik dhe loja** janë komponentë të rëndësishëm që nxisin ndërveprimet sociale të fëmijëve dhe përmirësojnë ndjeshmërinë e tyre ndaj të tjerëve. Mjediset e sigurt, të pasura dhe të përshtatshme për moshën e fëmijëve përmirësojnë përvojat sociale dhe ndërveprimin.
- **Ndërveprimi i rregullt dhe pozitiv me edukatorët dhe bashkëmoshatarët** është dëshmuar si faktor kyç në rritjen e kompetencës sociale të fëmijët. Ky rezultat mbështet teorinë bashkëkohore të zhvillimit, të cilat theksojnë rëndësinë e ndërveprimeve sociale dhe të mjedisit edukativ në ndërtimin e personalitetit dhe të sjelljeve sociale të fëmijëve. Cilësia e ndërveprimit me edukatorët dhe bashkëmoshatarët është një faktor thelbësor, marrëdhëniet pozitive dhe përkrahëse stimulojnë sjelljet sociale të dëshirueshme.
- **Prindërit kanë qëndrim pozitiv ndaj edukimit parashkollor.** Ata e vlerësojnë rolin e institucioneve në zhvillimin social të fëmijëve të tyre dhe e shohin si ndihmë për përgatitjen për shkollë.

Në përfundim, ky studim vë në dukje domosdoshmërinë e investimit në edukimin parashkollor të institucionalizuar dhe të qëndrueshëm, si një strategji afatgjatë për zhvillimin e qëndrueshëm social të fëmijëve. Rezultatet e këtij hulumtimi mund të shërbejnë si një bazë për edukatorët, prindërit dhe të gjithë ata që merren me edukimin në fëmijërinë e hershme, për të ndërtuar një edukim parashkollor gjithëpërfshirës, cilësor dhe të orientuar drejt zhvillimit të fëmijës si individ dhe si anëtar aktiv i shoqërisë.

3.12 REKOMANDIMET

- **Të promovohet përfshirja e hershme dhe afatgjatë në edukimin parashkollor** të institucionalizuar, rekomandohet që fëmijët të ndjekin institucionet parashkollore të paktën që nga mosha 3-vjeçare për të përfituar zhvillim më të mirë të aftësive sociale.
- **Të rritet edhe më shumë cilësia e ndërveprimit mes edukatoreve dhe fëmijëve** si dhe në mes bashkëmoshatarëve.
- **Të investohet në krijimin e mjediseve të sigurta, stimuluese dhe të pasura për lojëra**, e sidomos hapsira më të mëdha për zhvillimin e lojërave sociale në grupe të mëdha, sepse loja si aktivitet edukativ duhet të jetë në qendër të zhvillimit social të fëmijëve.
- **Të zhvillohen kampanja vetëdijësimi për prindërit**, qëllimi është informimi dhe motivimi i tyre për përfshirjen e fëmijëve në edukimin e hershëm parashkollor dhe mbështetja e zhvillimit social në shtëpi. Prindërit, sidomos në zonat rurale, duhet të informohen për përfitimet që sjell përfshirja e hershme e fëmijëve në institucione parashkollore.
- **Të realizohen hulumtime të mëtejshme**, sepse studime më të zgjeruara mund të ndihmojnë në vlerësimin më të thelluar të faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.

3.13 Referencat bibliografike

- Ata, S., Akman, B., & Deniz, A. (2012). The physical environment factors in preschools in terms of environmental psychology: a review <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S1877042812015534>. *Procedia - Social and Behavioral Sciences, Elsevier*, 2034 – 2039.
- Berk, L. E. (2009). *Child development*. Pearson.
- Bierman, K. L. (2004). *Peer rejection: Developmental processes and intervention strategies*. The Guilford Press.
- Bijandi, M. S., & Nabavi, R. T. (2011). Bandura's Social Learning Theory & Social Cognitive Learning Theory. *ResearchGate*, 23.
- Brada, R. (2013). *Pedagogjia Parashkolllore*. Prishtinë.
- Bruce, T. (2011). *Early childhood education*. Hodder Education.
- Clikeman, M. S. (2007). *Social Competence in Children*. New York, NY: Springer Science+Business Media.
- Curtis, A., & O'Hagan, M. (2015). *Care and Education in Early Childhood*.
- Denham, S. A. (2006). The Social Emotional Development. *Early Childhood Development and Care*, 176(2), 1–9.
- DiPerna, J. C. (2006). Academic enablers and student achievement: Implications for assessment and intervention services in the schools. *ResearchGate*, 43(1): 7-17.
- Duraku, Z. H. (2021). *Edukimi në fëmijërinë e hershme*. Prishtinë: Shtëpia Botuese Media Print.
- Gjelaj, M. (2014). Efektet e edukimit parashkollor në përgatitjen e fëmijëve për klasën të parë. Tiranë, Distertacion Doktorature.
- Gordon, A. M., & Broëne, K. W. (2014). *Beginnings and Beyond: Foundations in Early Childhood Education*. Cengage Advantage Books.
- Greenman, J. (1988). *Caring Spaces, Learning Places: Children's Environments That Work*. Exchange Press.
- Ho, J., & Funk, S. (2018). Preschool and child health: Evidence from China's universal child care reform. *Preschool*.
- Hussong, A. M., Zucker, R. A., Wong, M. M., Fitzgerald, H., & Puttler, L. I. (2005). Social Competence in Children of Alcoholic Parents Over Time. *Developmental Psychology*, 41(5):747-59.
- Jones, D., Greenberg, M., & Max, C. D. (2015). Early social-emotional functioning and public health: The relationship between kindergarten social competence and future wellness. *American Journal of Public Health*.

- Jurkic, A., Halliday, S. E., & Hascher, T. (2023). The relationship of language and social competence of preschool- and kindergarten-age single and dual language learners in Switzerland and Germany. *Early childhood Research Quarterly, Elsevier*.
- Karaj, T. (2005). *Psikologjia e zhvillimit të fëmijës*. Tiranë.
- Kaushik, A., Kostaki, E., & Kyriakopoulos, M. (2016). The stigma of mental illness in children and adolescents: A systematic review. *Psychiatry Research*.
- Kennedy, A. S. (2018). Promoting the social competence of each and every child in inclusive early childhood classrooms. *Early childhood education. IntechOpen*.
- Ligji Nr.08/L-153 Për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme. (2023). *Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës*.
- MASHT. (2011). *Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme*. Prishtinë.
- MASHT. (2016). *Korniza kurrikulare e Kosoves*. Prishtinë.
- Maxwell, L., & Evans, G. (2000). The Effects of Noise on Pre-school Children's Pre-reading Skills
https://www.researchgate.net/publication/222829526_The_Effects_of_Noise_on_Pre-school_Children%27s_Pre-reading_Skills. *Journal of Environmental Psychology*, 20(1), 91–97.
- Mooney, C. G. (2000). *Theories of Childhood: An Introduction to Dewey, Montessori, Erikson, Piaget, and Vygotsky*. Buena Vista University.
- Mulder, S. (2008). The Domains that Influence the Development of Social Competence in Children: A Literature Review. *The Graduate School University of Wisconsin-Stout*, 40.
- Musai, B. (1999). *Psikologji Edukimi*. Tiranë.
- Pacolli, F., Ramqaj, F., & Behrami, M. (2020). Pse Edukimi i hershëm është zgjidhja
<https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/16274-20201022.pdf>. *Friedrich Ebert Stiftung*, 7.
- Polat, O., Turker, S., & Akyol, N. A. (2022). Collaborative Learning with Mind Mapping in the Development of Social. *Eric*.
- Ren, M. (2024). Preschool and child health: Evidence from China's universal child care reform. *Economics of Education Review, Elsevier*.
- Schweinhart, L. J., Barnes, H. V., & Weikart, D. P. (1993). Significant benefits: The High/Scope Perry Preschool Study through age 27 (Monographs of the High/Scope Educational Research Foundation, No. 10).
- Shala, M. (2013). The Impact of Preschool Social-Emotional Development on Academic Success of Elementary School. *ResearchGate*.

- Shehu, B. P. (2021). *Kompetenca sociale e fëmijëve*. Prishtinë.
- Shonkoff, J. P., & Phillips, D. A. (2000). From neurons to neighborhoods. *The science of early childhood development*. National Academy Press.
- Slaughter, S. D. (2007). Demographic Profiles Associated with Academic Performance for Third Grade Students in North Forest and Aldine Independent School Districts in Texas. *Texas A&M University*.
- Spivack, A. J., Askay, D. A., & Rogelberg, S. G. (2009). *Contemporary physical workspaces: A review of current research, trends, and implications for future environmental psychology inquiry*. In J. Valentín & L. Gamez (Eds.), . New York, Nova Science Publishers. : Environmental psychology: New developments .
- Strickland, B. B. (2001). *The Gale encyclopedia of psychology*. Gale Group.
- T.Bowman, B., & Donovan, S. M. (2001). Eager to learn Educating our preschoolers. *National Academy Press*.
- Tadjic, M., Martinec, M., & Farago, A. (2015). THE IMPACT OF PHYSICAL SETTINGS ON PRE-SCHOOLERS CLASSROOM ORGANIZATION. *European Journal of Education Studies*.
- Tovey, H. (2007). *Playing Outdoors: Spaces and Places, Risks and Challenge (Debating Play)*. Maidenhead, United Kingdom: Open University Press.
- UNESCO. (2021). Right from the start: Build inclusive societies through inclusive early childhood education. UNESCO.
- Vadahi, F. (2002). *Pedagogjia Parashkolllore*. Shkodër.
- Woolfolk, A. (2011). *Psikologji Edukimi*. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik, CDE.
- Xie, H., Li, Y., Boucher, S. M., Hutchins, B. C., & Cairns, B. D. (2006). What makes a girl (or a boy) popular (or unpopular)? African American children's perceptions and developmental differences. *Developmental Psychology*, 42(4), 599–612.
- Zabeli, N. (2023). *Mësimdhënia efektive dhe kurrikula*. Prishtinë.
- Zigler, E., Gilliam, W. S., & Jones, S. M. (2006). A Vision for Universal Preschool Education. *Cambridge University Press*.

3.14 SHTOJCAT

Shtojca A: PYETËSOR PËR EDUKATORE

TEMA: NDIKIMI I EDUKIMIT PARASHKOLLOR TË INSTITUCIONALIZUAR NË ZHVILLIMIN E AFTËSIVE SOCIALE TË FËMIJËVE.

Të nderuara edukatore,

Ju falënderojë për gatishmërinë tuaj për të marrë pjesë në këtë hulumtim. Qëllimi im është që të thellojë njohuritë rreth ndikimit të edukimit parashkollor të institucionalizuar në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve, hulumtim ky që më nevojitet për realizimin e temës sime të Masterit.

- Pjesëmarrja juaj në këtë hulumtim është plotësisht vullnetare.
- Ju keni të drejtë të refuzoni pjesëmarrjen ose të tërhiqeni nga studimi në cdo moment, pa asnjë pasojë negative për ju.
- Të gjitha përgjigjet e juaja do të trajtohen në mënyrë konfidenciale. Të dhënat e mbledhura do të përdoren vetëm për qëllime hulumtimi dhe nuk do të lidhen me identitetin tuaj personal.

DEKLARATA E PËLQIMIT

Unë kam lexuar dhe kuptuar informacionin e dhënë për qëllimin dhe natyrën e studimit dhe jam e vetëdijshme për të drejtat e mia si pjesëmarrëse. Më është shpjeguar se pjesëmarrja ime është plotësisht vullnetare.

Me këtë deklaratë jap pëlqimin tim të lirë dhe të vetëdijshëm për të marrë pjesë në këtë studim.

E kuptoj që informacioni im do të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe do të përdoret vetëm për qëllime kërkimore.

Udhëzime: Ju lutemi plotësoni këtë pyetësor duke zgjedhur përgjigjen që përfaqëson më së miri mendimin tuaj, pyetjet janë të mbyllura dhe kërkohet nga ju që të rrethoni përgjigjen, të gjitha përgjigjet janë anonime.

Zgjidhni vetëm një opsion, përpos në pyetjet kur kërkohen më shumë opsione

PJESA I

PYETJE DEMOGRAFIKE

1.Sa vite përvojë pune keni si Edukatore?

- a) Më pak se dy vite
- b) 2-5 vite
- c) 6-10 vite
- d) Mbi 10 vite

2.Cili është niveli i arsimimit tuaj?

- a) Bachelor
- b) Master
- c) Doktoratë

3.Ku e zhvilloni profesionin tuaj si Edukatore?

- a) Edukatore në klasë parashkollore në kuadër të shkollës fillore?
- b) Edukatore në kopsht/Çerdhe

4.Cila është grupmosha e fëmijëve me të cilët punoni?

- a) 3-4 vjeç
- b) 4-5 vjeç
- c) 5-6 vjeç

5.Sa fëmijë keni në grup/klasë parashkollore?

- a) 0-10 fëmijë
- b) 11-15 fëmijë
- c) 16-20 fëmijë
- d) Më shumë se 20 fëmijë

PJESA II

NDIKIMI I EDUKIMIT PARASHKOLLOR TË INSTITUCIONALIZUAR

6.A mendoni se edukimi parashkollor i institucionalizuar ndihmon në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve?

- a) Po, shumë
- b) Po, në një masë të konsiderueshme
- c) Po, pak

7.Në çfarë niveli ishin të zhvilluara aftësitë sociale të fëmijëve para fillimit të edukimit parashkollor të institucionalizuar?

- a) Nivel të lartë
- b) Nivel mesatar
- c) Nivel të ulët

8.Pas një periodhe që fëmijët kanë ndjekur edukimin parashkollor, a keni vërejtur përmirësime në zhvillimin e aftësive sociale të tyre?

- a) Përmirësime shumë të mëdha
- b) Përmirësime të dukshme
- c) Disa përmirësime të vogla

9.Sa shpesh vëreni që fëmijët shfaqin aftësi për të bashkëpunuar, luajtur dhe ndarë lodrat me fëmijët e tjerë?

- a) Shumë shpesh
- b) Shpesh
- c) Ndonjëherë
- d) Rrallë

10. Si ka ndikuar zhvillimi i aftësive sociale në zhvillimin gjuhësor dhe emocional të fëmijëve? (Zgjidhni më shumë se një opsion)

- a) Ka pasur ndikim pozitiv
- b) Ka ndikuar në zhvillimin gjuhësor dhe ka krijuar një ambient emocional të sigurt
- c) Ka përforcuar lidhjet emocionale dhe gjuhësore
- d) Ka pasur ndikim të pjesshëm

11. Cilat aftësi sociale mendoni se janë më të vështira për ti zhvilluar në moshën parashkollore? (Zgjidhni më shumë se një opsion)

- a) Ndërtimi i marrëdhënieve miqësore
- b) Zgjidhja e konflikteve në mënyrë paqësore
- c) Rendi dhe disiplina në grup/klasë
- d) Empatia dhe ndjeshmëria ndaj të tjerëve

12. Cilat aktivitete në kopsht/ klasë parashkollore mendoni se kontribuojnë më shumë në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve? (Zgjidhni më shumë se një opsion)

- a) Lojërat me role
- b) Aktivitetet e lira
- c) Aktivitetet e strukturuar
- d) Bashkëveprimi direkt me edukatoren
- e) Bashkëveprimi direkt me bashkëmoshatarët

Pjesa III

Mjedisi fizik dhe loja

13. A e konsideroni të përshtatshëm dhe të dizajnuar mjedisin tuaj fizik në klasë, për të nxitur zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve?

- a) Po, është shumë i përshtatshëm
- b) Po, në një masë të konsiderueshme
- c) Po, por mund të përmirësohet më shumë
- d) Jo, ka nevojë për ristrukturim

14. Sa janë të sigurt dhe stimuluese hapsirat e jashtme të mjedisit për zhvillimin e lojërave sociale?

- a) Shumë të sigurt dhe shumë stimuluese
- b) Mesatarisht të sigurt dhe stimuluese
- c) Pak të sigurt dhe stimuluese

15. Sa janë të përshtatshme materialet dhe pasijet që i keni në klasë për të nxitur lojërë sociale?

- a) Shumë të përshtatshme
- b) Mesatarisht të përshtatshme
- c) Pak të përshtatshme

16. Sa të rëndësishme e konsideroni lojën për zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve?

- a) Shumë të rëndësishme, pasi nxjerr në pah aftësitë e bashkëpunimit
- b) E rëndësishme
- c) Mesatarisht e rëndësishme
- d) Pak e rëndësishme

17.Cilat lloje të lojës mendoni se kanë ndikim më të madh në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve? (Zgjidhni më shumë se një opsion)

- a) Lojërat e lira
- b) Lojërat me rregulla
- c) Lojërat me role
- d) Lojërat në grupe të vogla
- e) Lojërat kolektive

18.Cfarë rekomandime do të propozonit ju si Edukatore për të përmirësuar më shumë zhvillimin e aftësive sociale në institucione edukative parashkollore?

Faleminderit për kontributin tuaj

3.15 Shtojca B: PYETËSOR PËR PRINDËR

TEMA: NDIKIMI I EDUKIMIT PARASHKOLLOR TË INSTITUCIONALIZUAR NË ZHVILLIMIN E AFTËSIVE SOCIALE TË FËMIJËVE.

Të nderuar prindër,

Ju falënderojë për gatishmërinë tuaj për të marrë pjesë në këtë hulumtim. Qëllimi im është që të thellojë njohuritë rreth ndikimit të edukimit parashkollor të institucionalizuar në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve, hulumtim ky që më nevojitet për realizimin e temës sime të Masterit.

- Pjesëmarrja juaj në këtë hulumtim është plotësisht vullnetare.
- Ju keni të drejtë të refuzoni pjesëmarrjen ose të tërhiqeni nga studimi në cdo moment, pa asnjë pasojë negative për ju.
- Të gjitha përgjigjet e juaja do të trajtohen në mënyrë konfidenciale. Të dhënat e mbledhura do të përdoren vetëm për qëllime hulumtimi dhe nuk do të lidhen me identitetin tuaj personal.

DEKLARATA E PËLQIMIT

Unë kam lexuar dhe kuptuar informacionin e dhënë për qëllimin dhe natyrën e studimit dhe jam e vetëdijshme për të drejtat e mia si pjesëmarrëse. Më është shpjeguar se pjesëmarrja ime është plotësisht vullnetare.

Me këtë deklaratë jap pëlqimin tim të lirë dhe të vetëdijshëm për të marrë pjesë në këtë studim.

E kuptoj që informacioni im do të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe do të përdoret vetëm për qëllime kërkimore. Udhëzime: Ju lutemi plotësoni këtë pyetësor duke zgjedhur përgjigjen që përfaqëson më së miri mendimin tuaj, pyetjet janë të mbyllura dhe kërkohet nga ju që të rrethoni përgjigjen, të gjitha përgjigjet janë anonime.

Zgjidhni vetëm një opsion, përpos në pyetjet kur kërkohen më shumë opsione.

PJESA II

PËRCEPTIMET MBI NDIKIMIN E EDUKIMIT PARASHKOLLOR TË INSTITUCIONALIZUAR

1.Si ka ndikuar edukimi parashkollor në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijës tuaj?

- a) Ndikim i lartë
- b) Ndikim mesatar
- c) Ndikim i ulët

2.Në çfarë niveli mendoni se edukimi parashkollor i ka ndihmuar fëmijës tuaj të zhvillojë aftësi më të mira sociale dhe sjellje pozitive në klasë dhe në mjedise tjera?

- a) Nivel shumë i lartë
- b) Nivel i lartë
- c) Nivel mesatar
- d) Nivel i ulët

3.Sa shpesh flisini me fëmijën tuaj për rëndësinë e sjelljes pozitive?

- a) Shumë shpesh
- b) Shpesh
- c) Ndonjëherë
- d) Rrallë

4.A keni vërejtur përmirësime te fëmija juaj në zhvillimin e aftësive sociale si:ndihma ndaj bashkëmoshatarëve, bashkëpunimi, empatia (bashkëndjesia)?

- a) Përmirësime të shkëlqyera
- b) Përmirësime të kënaqshme
- c) Përmirësime mesatare

d) Përmirësime minimale

5.Sa të kënaqur jeni me qasjen e edukimit parashkollor për zhvillimin e aftësive sociale të fëmijës tuaj?

a) Shumë të kënaqur

b) Të kënaqur

c) Mesatarisht të kënaqur

d) Të pakënaqur

6.Cilat aktivitete në edukimin parashkollor mendoni se kontribuojnë më shumë në zhvillimin e aftësive sociale të fëmijës tuaj? (Zgjidhni më shumë se një opsion)

a) Lojërat me role

b) Aktivitetet e lira

c) Aktivitetet e strukturuar

d) Bashkëveprimi direkt me edukatoren

e) Bashkëveprimi direkt me bashkëmoshatarët.

7.Sa kohë në ditë i kalon fëmja juaj duke përdor paisjet teknologjike, si:Ipad/Tablet, telefon, lojëra me kompjuter etj?

a) 3 orë e më shumë

b) 2 orë

c) 1 orë

d) Më pak se 1 orë

8.A mendoni se edukimi parashkollor e ka ndihmuar fëmijën tuaj të përgatitet për marrëdhëniet sociale në shkollën fillore dhe në mjedise tjera jashtë shkollës?

- a) Shumë mirë
- b) Mirë
- c) Mesatarisht
- d) Minimalisht

9.Si e vlerësoni punën e edukatorëve në ndihmën e fëmijës tuaj për të zhvilluar aftësi sociale?

- a) E shkëlqyeshme
- b) E kënaqur
- c) Mesatare
- d) Jo e kënaqshme

10.Cfarë rekomandime do të propozonit ju si Prindër për të përmirësuar më shumë zhvillimin e aftësive sociale në institucione edukative parashkollore?

Faleminderit për kontributin tuaj!